



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore znj. Yllka Rupa.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.<sup>1</sup>*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Emona Muçi* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

<sup>1</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim:* Nuk mori pjesë në trajtimin e çështjes së parë z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *{...}, gjyqtare.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore znj. Yllka Rupa.

*Naureda Llagami:* Po fillojmë mbledhjen e sotshme të datës 3 prill. Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje për më se 18 akte. Në fakt dy aktet e fundit janë shtuar për shkak të prioritetit që kanë, që kanë të bëjnë me miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe miratimin e komenteve dhe sugjerimeve për rezultatet e vlerësimit paraprak që ka bërë Shkolla.

Pa humbur kohë po fillojmë me çështjen e parë nëse s’kemi diskutime mbi aktet që propozohen sot.

Çështja e parë ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Në fakt nga administrata

njoftohem që zonja {...} ka ardhur personalisht vetë. Kështu që ftojme zonjën {...} që të jetë këtu.

*(Futet në sallën e mbledhjes gjyqtarja {...}.)*

**Naureda Llagami:** Përshëndetje!

Mirë se erdhe zonja {...}.

Shkurtimisht për procedurën. Fillimisht fjala i jepet relatores për të relatuar projektraportin tuaj i cili ka të bëjë me gradimin, pra i përket periudhës 2013-2016, dhe më pas fjala ju jepet juve, që shkurtimisht të jepni, atë, qëndrimin tuaj lidhur me projektraportin dhe më pas do të vijoni për të lejuar Këshillin që të marrë vendimmarrjen e tij mbi raportin tuaj të vlerësimit. Kështu që pa humbur kohë, fjalën ia jap zonjës Rupa.

**Yllka Rupa:** Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

E nderuar zonja {...}!

Po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2013-2016. Ky projektraport ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, pra gradimin e gjyqtarës e cila ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në projektraport pasqyrohet sipas rendit kronologjik i gjithë procesi vlerësues i gradimit të gjyqtarës. Gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime lidhur me një tregues, që i referohet aftësive organizative, në kuptimin e kryerjes së procedurave për shmangien e seancave joproductive.

Në mënyrë të përmbledhur unë po referoj për gjithsecilin nga kriteret për nivelin e pikëzimit dhe vlerësimin mbi bazën e të cilëve vlerësohet gjyqtarja si dhe treguesit përkatës.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, në aspektin e 1.A. Njohurive ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, ka rezultuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtarja e arrin nëpërmjet

analizës së integruar më vete dhe në tërësi të provave, pavarësisht pretendimeve të palëve mbi rrethanat e faktit. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, përcaktimi të cilin e bën në mënyrë të shprehur, duke e referuar si konkluzion të analizës së saj mbi objektin dhe shkakun ligjor të padisë. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikët 25.

Për të kaluar në 1.A.b Aftësitë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të zbatuar, referuar dhe kur është rasti për të analizuar aspektet të procesit të rregullt ligjor, posaçërisht lidhur me elementin e barrës së provës, si dhe për të referuar parime të tjera procedurale dhe materiale, në mbështetje të interpretimit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, gjyqtarja ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikues, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ në mbështetje të argumenteve të saj me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes.

Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikëzimi 25.

Për të kaluar tek 1.B Arsyetimi ligjor. Në drejtim të 1.B.a Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjyqtarja rezulton në një nivel shumë të mirë, kështu që propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15.

Po ashtu edhe lidhur me treguesin tjetër 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit gjyqësor, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Propozohet niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikët 10.

Në lidhje me 1.B.c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, mbështetur në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, gjyqtarja arsyeton vendimet. Vendimi është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Propozohet niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikët 25.

Lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek 2. Aftësitë organizative të gjyqtares, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, për sa i takon 2.A.a. Respektimit të afateve ligjore.

Pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna të tjera që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, prezumohet se gjyqtarja i ka gjykuar të gjitha çështjet brenda afateve ligjore, kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore. Duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale gjykimi i një çështjeje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues ende në fuqi.

Referuar afatit 87-ditor të llogaritur si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 17 çështje të analizuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritjeje vetëm matematikore, 5 prej tyre ose 29.4% e çështjeve, kanë përfunduar përtej këtij afati. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo përqindje pikëzohet me 3 pikë.

Përtej një analize të thjeshtë, lidhur me vlerësimin e këtij treguesi, janë vlerësuar edhe rrethanat që përgjithësisht nuk janë përgjegjësi e gjyqtares dhe që kanë ndikuar në shqyrtimin e çështjeve përtej standardit minimal kohor të tilla si ecuria procedurale e çështjeve, formimi i trupit gjykues të përbërë nga tre anëtarë, mosnjohimi rregullisht i palëve ndërgjyqëse për shkak të problemeve të shërbimit postar apo adresave të pasakta, mungesa e palëve ndërgjyqëse, mosparaqitja e provave nga pala e paditur, e të tillë elementë si këto. Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara gjyqtarja ka përfunduar si relatore 1891 çështje, a të cilat përgjatë kësaj periudhe ajo ka gjykuar 990 çështje me palë kundërshtarë, mesatarisht rreth 330 çështje në vit çështje

me palë kundërshtare. Në këto kushte unë propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet me nivelin maksimal dhe pikët të rriten pra me dy nivele vlerësimi.

Lidhur me 2.A.ç. Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit është 88.3 %, përqindje e cila sipas metodologjisë vlerësohet me 6 pikë. Por duke qenë se gjyqtarja e tejkalon me 120 % në vit standardin, propozoj nivelin e pikëzimit me 10 pikë lidhur me këtë tregues.

Në lidhje me 2.A.d. Kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor rezulton se në të gjitha vendimet për të gjitha kategoritë e çështjeve kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar ligjor, kështu që propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Për të kaluar tek 2.B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore 2.B.a. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale. Nga tërësia e të dhënave numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 26 seanca. Numri i përgjithshëm i seancave të planifikuara është 63 seanca gjyqësore. Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë “administrative me palë kundërshtare” numri mesatar i seancave gjyqësore është 6 seanca gjyqësore, për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune” numri mesatar është 4.6 seanca gjyqësore. Kështu që numri mesatar i seancave duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 13 çështjeve rezulton të jetë 4.8 seanca.

Në kundërshtimet e paraqitura gjyqtarja shprehet se nga dosjet e shqyrtuara vetëm në dy prej tyre është konstatuar shumica e seancave joproduktive për të cilat është evidentuar në mënyrë të shprehur edhe në projektraport se asnjëra prej tyre nuk janë shtyrë për shkak të gjyqtarës. Bëhet fjalë për dy dosje të cilat janë evidentuar, njëra për efekt të vlerësimit etik dhe profesional për zvarritje gjykimi. Është një dosje e cila është ankimuar në bazë të një ankese të një shtetasi. Kjo çështje ka përfunduar për 26 seanca gjyqësore dhe përgatitore (21 seanca gjyqësore, nga të cilat 10 seanca gjyqësore joproduktive). Ndërsa është një dosje tjetër e zhvilluar me 16 seanca gjyqësore (nga të cilat 9 janë joproduktive). Në raportin e KLD-së evidentohet se disa herë u shtynë seancat sepse eksperti nuk kishte mbushur siç duhet detyrën e ngarkuar nga gjykata dhe nga

gjqtarja nuk u mor asnjë masë për ndëshkimin e ekspertit. Nëse gjyqtarja do të kishte qenë më e qartë në përcaktimin e detyrave konkrete që duhet të zgjidhte eksperti, kjo do të evitonte përsëritjen e ekspertizës dy herë. Gjithashtu nëse gjyqtarja do të kishte ndëshkuar ekspertin më gjobë, -flitet në raport- në rastin e neglizhencës nga ana e tij në kryerjen në kohë të detyrave të ngarkuara, ky i fundit do të ishte më i përgjegjshëm në kryerjen e detyrave.

Konkluzioni në lidhje me verifikimet e mësipërme ishte që zvarritja e gjykimit të çështjeve civile nga gjyqtarja, të mbahet në konsideratë si mangësi në vlerësimin e saj etik dhe profesional për këtë periudhë.

Evidentohet që është detyrë e gjyqtarit që në kuadër të garantimit të procesit të rregullt ligjor të zbatojë mekanizmat procedurale dhe për të marrë masa për reduktimin e seancave joproduktive të cilat mund të çojnë në një tej zgjatje në kohë të gjykimit të çështjes duke cenuar kështu të drejtën e palës për një proces të rregullt. Në këto kushte unë kam propozuar që ky tregues të vlerësohet në nivelin e 9 pikëve.

Lidhur me 2.B.b. Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor nga burimet e vlerësimit lidhur me këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka aftësi të shumë të larta duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në veprimet përgatitore, në seancat përgatitore, dhe seancat gjyqësore të zhvilluara. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit “shumë i lartë” lidhur me këtë tregues, pikët 20.

Lidhur me 2.C. Aftësitë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore, në të dy treguesit që kanë të bëjnë me 2.C.a. Rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes dhe 2.C.b. Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 5 dhe 10.

Kështu që niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit për “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet të jetë, pikët 94, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”. Për sa i takon “Etikës në punë”, 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për

këtë tregues gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin shumë të lartë dhe të pikëzohet me 35 pikë.

Lidhur me “Integritetin e gjyqtares”, referuar të dhënave rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integriteti si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin. Propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit, pikët 40.

Lidhur me “Paanësinë e gjyqtares”, në aspektin e 3.C.a. Përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10.

Për të kaluar tek 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares ku konstatohet se është i pa konsiderueshëm, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë lidhur me këtë tregues.

Kështu që lidhur me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale” gjyqtarja propozohet të vlerësohet me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, lidhur me 4.A Aftësitë e komunikimit 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale. Propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 25.

Po ashtu respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet nivel i lartë vlerësimi, pikët 15.

4B. Aftësia për të bashkëpunuar, paraqitet në nivele shumë të mira si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me to, ashtu edhe në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Propozohet niveli i pikëzimit 15 dhe 10 pikë. Nivel shumë i lartë pikëzimi për të dy treguesit.

Në lidhje me 4C. Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, për sa i takon 4.C.a. Pjesëmarrjes së gjyqtares në programet e formimit vazhdues të



Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës administrative dhe gjykimit administrativ, gjithsej 23 aktivitete të zhvilluara për 34 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën trevjeçare. Propozohet vlerësimi për këtë tregues me 20 pikë.

Për sa i takon 4.C.b. Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë angazhime të tilla, kështu që vlerësimi do të fillojë... do të pikëzohet lidhur me këtë tregues me 3 pikë.

Po ashtu edhe lidhur me 4.C.c. Angazhimin e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale nuk provohet të ketë angazhime aktive për të përmirësuar sistemin e drejtësisë, duke iu referuar komponentëve mbi bazën e të cilëve vlerësohet treguesi, pra nuk rezulton që gjyqtarja të ketë pjesëmarrje në tryeza, konferenca dhe të ketë rol aktiv në to, prandaj propozohet niveli i pikëzimit me 3 pikë lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 4.C.ç. Publikimeve ligjore akademike, nuk rezulton të ketë të tilla, pra nuk vlerësohet lidhur me këtë tregues.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për gjithsecilin kriter vlerësimi është si më poshtë “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë organizative të gjyqtares”, pikët 94, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm 385 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, fjala është për ju zonja {...}, shkurtimisht. Ne jemi vënë në dijeni me atë çfarë ju kërkoni. Keni të drejtën për të shpjeguar konkretisht.

{...}: Faleminderit e nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

E nderuar relatore!

Së pari ju falënderoj që më dhatë mundësinë për ta prezantuar personalisht ankimin tim ndaj projektraportit të vlerësimit i cili siç jeni vënë në dijeni konsiston në vetëm një nga pikat e treguesve “Aftësinë e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore”. Pretendimet e mia janë gjithmonë brenda konstatimeve të vetë projektraportit. Nuk kam kundërshtime sa i takon atyre çfarë janë evidentuar në projektraport lidhur me dosjet e vëzhguara, pasi bëhet fjalë për numrin e seancave, e cila sipas vlerësimit e kalon mesataren e seancave sipas metodologjisë së vlerësimit.

Dua t’ju bëj me dije se, duke iu referuar edhe konstatimeve të projektraportit, bëhet fjalë për 11 dosje dhe siç u evidentua edhe nga relatorja, numri më i madh i këtyre seancave konstatohet në vetëm 2 prej tyre. Pra dua të bëj prezent faktin që në dosjet e tjera të cilat sigurisht, duke qenë se janë vlerësuar vetëm 11 dosje, nuk jam as unë në gjendje të them se si do të ishte treguesi nëse do vlerësoheshin të gjitha dosjet një për një të gjykuara nga ana ime, por duke iu referuar metodologjisë së vlerësimit, po marrim të mirëqenë këtë mënyrë se si është bërë ky vlerësim. Pra nëse në 9 dosje të tjera nuk rezulton një fenomen i tillë, rezulton vetëm në dy dosje. Dua të them në gjykimin tim që tendenca ime ka qenë për ta respektuar edhe këtë kriter të gjyqimit, pra për të bërë përpjekjet maksimale për të shmangur seancat joproduktive, gjë që është tregues në këto 9 dosje.

Sa i takon dy dosjeve, çështjet kanë qenë me problematika, sidomos njëra prej tyre. Është fakt që janë shtyrë disa seanca, por duke gjykuar edhe konstatimet e bëra nga vetë relatorja në projekt evidentohet që së pari asnjë nga këto seanca nuk është shtyrë për faj të gjyqtares; evidentohet fakti që edhe kur seancat janë shtyrë për shkak të një arsye timen objektive, sërish jam përpjekur që t’i akoma më afër sesa seancat e tjera të rutinës normale; është evidentuar gjithashtu edhe fakti që të gjitha shtyrjet janë konstatuar për shkaqe procedurale që u relatuan, që lidhen me njoftimet e palëve, me kërkesat e tjera,

me komunikimet, pakësimet e objektit të padisë, njoftimi i ekspertit, shpërndarja e aktit të ekspertimit; gjithashtu është evidentuar edhe fakti që nga vëzhgimi i këtyre 11 dosjeve është mbikëqyrur siç duhet kryerja e veprimeve procedurale, e njoftimeve, pra duke e marrë këtë tregues në tërësinë e tyre, në gjykimin tim mendoj që edhe për këtë pikë duhet të vlerësohem me kriterin maksimal, duke mos u përgjithësuar puna ime me konstatimet e këtyre dy dosjeve, të cilat qëndrojnë, nuk kam asnjë kundërshtime sa është evidentuar në projektraport, por duke vlerësuar edhe numrin e madh të çështjeve që kam gjykuar i cili në rubrika të tjera është parë e arsyeshme nga relatorja për t'u vlerësuar si tregues pozitiv, dhe për të rritur pikë, vlerësoj që edhe në këtë kriter vlerësimi im të jetë me pikët maksimale.

Sigurisht numri i madh i seancave është një nga detyrat që gjyqtarët duhet ta shmangin. Mendoj se bëj përpjekjet e mia, për ta shmangur edhe unë këtë numër seancash inproduktive, sepse nuk i shërben zgjidhjes mirë të çështjeve por edhe ecurisë së gjykimit, dhe performancës së gjyqtarëve në raport me publikun. Por ka edhe çështje të cilat për vetë ngarkesën që mbartin për llojin e konfliktit, për problematikat që sjellin edhe avokatët edhe institucionet, bëjnë edhe që të ketë një numër seancash joproduktive.

Gjithsesi gjykoj se jam munduar që edhe në këto raste të vendos në balancë të drejtë ruajtjen e një numri standard apo të shkurtër seancash për të qenë në rregull me kriteret e vlerësimit apo të ruaj balancën ndërmjet faktit që çështja duhet të zgjidhet ashtu siç duhet, të kryhet hetimi i plotë gjyqësor, pavarësisht se mund të shtyhet seanca dhe të krijohet mundësia që të bëhet i tillë që palëve në konkluzionet përfundimtare, në vendimet përfundimtare t'i jepet përgjigjja në mënyrë shteruese pretendimeve të tyre. Gjithsesi këto janë fakte. Nuk është se kundërshtoj ato që ka kundërshtuar relatorja por duke vlerësuar në tërësi të gjithë këtë konstatim, gjykoj që edhe për këtë kriter, ajo mbetet në gjykimin tuaj, por gjykoj që të vlerësohem me 15 pikë.

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Paraprkisht nëse ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Jo!

Shumë faleminderit për pjesëmarrjen.

{...}: Edhe unë ju falënderoj që më lejuat prezantimin.

(Del nga salla e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim paraprak?

Relatorja?

Jo! – nuk ke.

Irena!

**Irena Plaku:** Atëherë, unë kam një propozim për sa i përket treguesit për të cilën gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime. Unë propozoj që t'i rriten pikë duke shkuar nga 9 në 15, pasur parasysh në fakt në të gjithë projektraportin e vlerësimit, që janë dy çështje (atë që theksoi edhe gjyqtarja) dhe po të shikosh arsyet për të cilat janë shtyrë çështjet, konkretisht një çështje, që është dosja numër 4, rezulton se është shtyrë 4 herë për mosformim të trupit gjykues, ku ndër të tjera thuhet se çështja ka qenë me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata Administrative e Korçës ka funksionuar me 2 gjyqtarë, dhe katër seanca janë pritur për të formuar trupin gjykues. Gjithashtu konstatohet në projektraport që janë shtyrë, në një çështje, 7 seanca janë shtyrë për ekspertin. Janë shtyrë disa seanca për njoftimin e palëve dhe po të shikosh edhe për çështjen të cilën ka referuar ish-Inspektorati i KLD-së, referohet që asnjëherë nuk ka qenë për shkak të gjyqtarës, por për arsye të palëve ndërgjyqëse, konkretisht atij që e ka paraqitur ankimin dhe palëve të tjera që kanë qenë në proces, ku në një rast gjyqtarja ndër të tjera ka vendosur dhe gjobë për njërën nga palët në proces për shkak se nuk ka paraqitur provat në kohën e duhur, domethënë disa nga palët në proces kanë shtyrë gjithmonë seancën për të paraqitur provat në formën e kërkuar, ku një ndër palët ka qenë edhe institucion shtetëror. Gjithashtu po të shikosh nënçështjet e tjera për të cilën janë burimet e vlerësimit, rezulton se numri i seancave ka qenë shumë i shkurtër ku gjyqtarja ka marrë masat që çështjet të përfundojnë në një seancë gjyqësore; në dy-tre raste janë shtyrë me kërkesë të palëve për të paraqitur konkluzionet përfundimtare dhe është shpallur vendimi direkt; në një rast ishte shtyrë në 4 seanca vetëm për mosnjoftim të palëve, çka do të thotë që gjyqtarja në çdo rast ka marrë masa për të përfunduar çështjen brenda (ndërpritet audio).

Atëherë, pasur parasysh edhe praktikën e Këshillit që pavarësisht që numri i seancave ka rezultuar mbi tre por ka qenë 5, 6, 7, 8 në një rast, dhe më shumë, pasur parasysh se asnjëherë, kur ka rezultuar që asnjëherë gjyqtari nuk ka qenë shkak për shtyrjen e këtyre seancave, për numrin e lartë të seancave, kam vendosur pikëzimin maksimal. Për këto arsye, unë propozoj pikëzimin maksimal me 15.

**Naureda Llagami:** Faleminderit znj. Plaku!

Po, zoti Kurushi e ka fjalën.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, në vijim të propozimit që bëri zonja Plaku, unë dakordësohem me këtë propozim; do t'i shtoja vetëm dy argumente, pa humbur shumë kohë. Përtej atyre komponentëve që i vuri në dukje zonja Plaku, unë do shtoja faktin që është një gjyqtare me përvojë jashtëzakonisht të madhe në sistemin gjyqësor. Është mbi 28 vite në detyrë dhe mund të jetë nga gjyqtaret në juridiksionin administrativ me përvojën më të lartë gjyqësore dhe kjo ka reflektuar tek performanca e saj në çështjet e përzgjedhura për t'u vlerësuar gjatë viteve 2013-2016.

Përveç kësaj, sikundër e tha edhe vetë gjyqtarja, doja të evidentoja faktin e ngarkesës së punës që ka pasur ajo gjyqtare personalisht gjatë 2013-2016, ka mbajtur një ngarkesë më tepër sesa dyfishi i normës së përcaktuar në vendimet e KLD-së. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, hedhim në votim propozimin e bërë nga dy kolegët tashmë, edhe nga zonja Plaku dhe nga zoti Kurushi, për rritjen e indikatorit që ka të bëjë me numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, nga 9 pikë në 15 pikë. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Kundër.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi, miratimin e raportit të vlerësimit me qëllim gradimi të për periudhën 2013-2016 për gjyqtaren {...}. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 391 pikë. Miratohet ky raport.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>2</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>6. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Markelian Koça</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>2</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

8. *Emona Muçi* (anëtare)  
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*Shënim 2:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

(Për shkak të angazhimeve të tjera, *znj. Llagami* u largua nga mbledhja dhe drejtimin e saj e mori z. Rusi. Gjithashtu u fut në sallën e mbledhjes anëtarja z. Koça i



*cili nuk mori pjesë në shqyrtimin e çështjes së parë të rendit të ditës. Ndërkohë zonja Irena Plaku gjithashtu u largua nga salla dhe nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Pas rreth 30 minutash pushimi rifilloi mbledhja plenare.)*

**Ilir Rusi:** Në vijim mbledhja do të drejtohet nga ana ime, zv/kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak se Kryetarja kishte impenjime, angazhime institucionale. Vazhdojmë me pikën dy të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK-ja. Relator është z. Kurushi. Për më tej fjalën z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Rusi!

Në mbledhjen plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele më datë 14.06.2023, rezultuan se u paraqitën gjithsej 5 (pesë) kandidatura.

Këshilli me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim ose asnjë vlerësim për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e Lezhë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Nga kjo listë rezulton se për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton vetëm 1 (një) kandidat i cili mund të kishte 2 (dy) vlerësime (në atë kohë), pikërisht z. {...}; ndërsa kandidatët e tjerë z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} gjenden në shtojcën III të vendimit nr. 346, datë 27.06.2023, të identifikuar si kandidatë të cilët nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në vijim, me vendimin nr. 45, datë 31.01.2024, Këshilli ka vendosur: “1.Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ku është caktuar në mënyrë të përhershme...”

Në këto rrethana, në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 kandidatë të mbetur në garë rezultojnë z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë [...]”.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedurën e detajuar përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020.

Në Kreun IV të vendimeve nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit, janë përcaktuar procedurat përkatëse që do të ndiqen si më poshtë:

“IV. Procedura e lëvizjes paralele:

Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në rastin kur për pozicionin e lirë në një gjykatë të shkallës së dytë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kritereve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët sipas shkronjës “a”, të pikës 13, të këtij vendimi.

Këshilli, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023 ndër të tjera ka vendosur: Miratimin e listës së gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe lista shtojca përkatëse me listën e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim (janë pjesë e integruar e relacioni – nuk po i përmend një nga një emrat).

Në këto kushte, në përputhje me pikën 11 të vendimeve, nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023, dhe vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 të vitit 2023.

Struktura e projektvendimit:

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Në pikën e dytë – caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 3 (*lapsus, pasi janë katër kandidatë*) kandidatët të cilët sipas shtojcës III të vendimit nr. 346, datë 27.06.2023, nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim: z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për shkak të ngarkesës propozohet që Kryetari i Komisionit, z. Klodian Kurushi të përjashtohet nga procedura verifikimit.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 4 (katër) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurën e lëvizjes paralele në pozicionet nr. 256, 257 dhe 258 dhe që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Më pas, shorti do të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 2 (dy) kandidatë (katër kandidatë: dy njëri relator dhe dy relatori tjetër).

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Këto janë propozimet.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga zoti Kurushi?

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime mbi relacionin e prezantuar nga zoti Kurushi dhe mekanizmin e hedhjes së shortit, ftoj administratën në hedhjen e shortit.

Procedura e hedhjes së shortit:

Në një vazo hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e dy anëtarëve të KLZH-së (relatorë): z. Alban Toro dhe z. Markelian Koça.

Në vazën tjetër hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet shiriti me emrin e relatorit të parë, që është z. Alban Toro. Për z. Toro përzgjidhen dy shirita me emrin e kandidatëve: znj. {...} dhe znj. {...}.

Përzgjidhet shiriti me emrin e relatorit të dytë, që është z. Markelian Koça. Për z. Koça përzgjidhen dy shirita me emrin e kandidatëve: znj. {...} dhe z. {...}.

***Ilir Rusi:*** Ka diskutime mbi hedhjen e shortit?

Meqenëse nuk ka diskutime mbi hedhjen e shortit, vazhdojmë me votimin e projekt-aktit, përditësuar sipas përmbajtjes së shortit të sapo hedhur.

***Gentiana Muçaj:*** Pjesërisht dakord dhe jam kundër vetëm për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë për kandidaten {...} për shkak se mendoj se

ekziston konfliktit i interesit, qoftë edhe në dukje, për aq kohë sa është e komanduar pranë këtij Këshilli tek komisionet e përhershme.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord, me një koment të vogël. Për sa kohë ne e kemi sjellë edhe kandidaten {...} në procedurën e fillimit të verifikimit të kriterëve ligjore, kemi menduar që nuk ekziston asnjë situatë konflikti, qoftë edhe në dukje, interesi në këtë rast, sepse Këshilli nuk ka asnjë diskrecion në procedurën e vlerësimit, qoftë të verifikimit të pasurisë, qoftë verifikimit të figurës, qoftë edhe të verifikimit të kriterëve etike dhe profesionale. Kështu që nuk ka konflikt interesi sipas mendimit të Komisionit. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>3</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Markelian Koça</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>3</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

**9. Emona Muçi** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
6. **Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
7. **Edmond Hoxhaj, Birn.**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*(U fut në sallën e mbledhjes znj. Irena Plaku e cila nuk mori pjesë në pikën pararendëse.)*

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses



procesin e rivlerësimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Muçi.

***Emona Muçi: Faleminderit!***

Atëherë, nga ana e Komisionit është përgatitur projektvendimi në lidhje me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit dhe konkretisht për gjyqtaren {...}, gjyqtaren {...}, gjyqtarin {...} dhe gjyqtarin {...}.

Deri në datën 29.03.2024 nga organet e rivlerësimit kalimtar janë dërguar gjithsej 136 dosje (nga të cilat ka filluar procesi i gradimit për 121 gjyqtarë, për 82 prej tyre ka mbaruar dhe për 2 gjyqtarë të tjerë për shkak të vendimmartjeve janë marrë vendimet për pezullim të procedurave për shkak të zgjedhjes si anëtarë të KLGJ-së apo përfundim i procedurës pa vendim përfundimtar.

Në lidhje me gjyqtarët e përmendur në projektvendim, me shkresën nr. {...} prot., datë 19.01.2024 janë përcjellë dosjet e vlerësimit profesional për gjyqtarët {...} dhe {...}; Me shkresën nr. {...} prot., datë 29.01.2024 janë përcjellë dosjet e vlerësimit profesional për gjyqtarët {...} dhe {...}.

Vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që kanë kaluar procesin e rivlerësimit me qëllim përcaktimin e gradës së vlerësimit, për periudhën e rivlerësimit që përfshin vitet 2013-2016, është përgjegjësi e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve. Kjo përgjegjësi është rregulluar më tej në ligjin “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar, neni 86, shkronja dh) dhe në nenin 68 e vijues e të Ligjit për Statusin.

Në zbatim të kuadrit ligjor si më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar disa akte nënligjore që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve dhe gjithashtu përcaktojnë rregulla për procedurën e përcaktimit të nivelit të gradimit të tyre.

Aktualisht pranë Këshillit, me shkresat e sipërcituara janë përcjellë dosjet me aktet e nevojshme për vlerësimin profesional për gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...}. Nga verifikimi i vendimeve për secilin gjyqtar rezulton, si më poshtë:

1. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur

të Kualifikimit nr. {...}, datë 04.01.2024, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mos ankimit.

2. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {...}, datë 20.12.2023, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mos ankimit.

3. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, është konfirmuar në detyrë me vendimin nr. {...}, datë 03.07.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili ka ndryshuar vendimin nr. {...}, datë 21.04.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

4. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {...}, datë 21.07.2020, vendim i cili ka marrë formë të prerë pasi është lënë në fuqi me vendimin nr. {...}, datë 24.07.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Për sa më lart, mbështetur në nenet 89, pika 1 dhe 171, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, si dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së vlerësimit për përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për 4 gjyqtarët e mësipërm që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit” dhe që gjatë periudhës 3-vjeçare nuk u evidentua paraprakisht të kishin më pak se 1 (një) vit punë si gjyqtar.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional që janë marrë gjatë procesit të rivlerësimit.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatores dhe nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa. Duke mbajtur parasysh për aq sa

është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës, është vlerësuar që për anëtarin Emona Muçi të shorohen 2 procedura vlerësimi, për anëtarin Yllka Rupa 1 procedurë vlerësimi dhe për anëtarin Irena Plaku 1 procedurë vlerësimi. Ndërsa për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, shorti do të realizohet ndërmjet 2 nëpunësve të Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, të angazhuar me vlerësimet periodike të gjyqtarëve, sipas nenit 12, pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 znj. Erlanda Agaj dhe znj. Merita Karaj dhe me një ngarkesë pune të barabartë, me nga 2 vlerësime secila.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit znj. Muçi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në përgatitjen e shortit sipas mekanizmit të propozuar nga relatorja.

Procedura e hedhjes së shortit:

Në një vazo hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Në vazën tjetër hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi (2 shirita); znj. Irena Plaku; znj. Yllka Rupa.

Në vazën e tretë hidhen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Erlanda Agaj (2 shirita) dhe znj. Merita Karaj (2 shirita).

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet shiriti me emrin e gjyqtarit të parë, që është znj. {...}. Për znj. {...} përzgjidhen relatore znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e gjyqtarit të dytë, që është z. {...}. Për z. {...} përzgjidhen relatore znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e gjyqtarit të tretë, që është znj. {...}. Për znj. {...} përzgjidhen relatore znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e gjyqtarit të katërt, që është znj. {...}. Për znj. {...} përzgjidhen relatore znj. Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës znj. Merita Karaj.

**Ilir Rusi:** Keni diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit të përditësuar sipas të dhënave të rezultuara nga shorti i sapo hedhur.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

i) Për gjyqtaren {...} – Relatore znj. Emona Muçi – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

ii) Për gjyqtaren {...} – Relatore znj. Yllka Rupa – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj;

iii) Për gjyqtaren {...} – Relatore znj. Irena Plaku – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

iv) Për gjyqtarin {...} – Relatore znj. Emona Muçi – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Theksoj faktin që në pikën 3 u rikthye zonja Plaku për shkak se në pikën 2 nuk mori pjesë në shqyrtimin, diskutimin dhe votimin e saj.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>4</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Markelian Koça</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>9. Emona Muçi</i></b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>4</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

*Alban Toro:* Relacioni në fjalë ka lidhje me përpjekjet që ka bërë KLGJ-ja për të normalizuar aktivitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Durrës. Kjo gjykatë në strukturën organizative ka 23 gjyqtarë, aktualisht në detyrë janë vetëm 11 gjyqtarë. Në tabelë ju kam pasqyruar momentet dhe statusin e gjyqtarëve, disa prej të cilëve ju është pezulluar për shkak të procedurës së vlerësimit kalimtar dhe disa janë të komanduar në institucione të ndryshme. Gjithashtu ju kam pasqyruar në relacion në mënyrë të ndërthurur përpjekjet që ka bërë KLGJ për të normalizuar aktivitetin e kësaj gjykate por njëkohësisht edhe faktet juridike që në një farë mënyrë kanë ndikuar për të identifikuar këtë gjykatë si gjykatë në nevojë.

Konkretisht, me vendimin nr. {...}, datë 22.04.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur “Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës...”.

Me vendimin nr. {...}, datë 25.02.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur “Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës...”.

Me vendimin nr. {...} datë 24.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur “Shkarkimi nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës...”.

Me vendimin nr. {...}, datë 14.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur “Pezullimi nga detyra të magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, caktuar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë.

Me vendimin nr. {...}, datë 11.10.2023, Këshilli ka vendosur: “Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës të gjyqtares znj. {...} deri në datë 16.10.2025...”.

Gjithashtu, një nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ka qenë gjyqtar pranë kësaj gjykate dhe si rrjedhim ndikon në mungesën e burimeve njerëzore të kësaj gjykate.

Me vendimin nr. 94/2024 Këshilli ka vendosur: Komandimin e gjyqtares {...} si pedagoge në Shkollën e Magjistraturës deri në datën 20.02.2026. Kjo vendimmarrje është detyrim i përcaktuar në nenin 265 të Ligjit nr.115/2016 dhe aplikuar nëpërmjet mekanizmit të përcaktuar në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, e cila me vendimin nr. 659, datë 02.11.2023 ka vendosur: “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në



Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”, duke shprehur në mënyrë të qartë nevojën e domosdoshme që në radhët e pedagogjike të saj të ketë komponentë të gjyqësorit për të transferuar eksperiencën e tyre në brezin e ri të magjistratëve.

Me vendimet nr.102/2024 dhe nr.103/2024 Këshilli ka vendosur: “Përsëritjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës të gjyqtarit z. {...} /z. {...}, për një periudhë deri në 1 (një) vit...”.

Me vendimin nr.155/2024 Këshilli ka vendosur: *Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Këshilltar ligjor”, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 08.04.2024.* Këshilli i Lartë Gjyqësor, megjithëse në bazë të nenit 147 të Kushtetutës i është përcaktuar një fizionomi të një institucioni me kompetenca të qartë jo vetëm në fushën e emërimit, promovimit dhe disiplinimit të gjyqtareve por edhe kompetenca të qarta në fushën e administrimit të gjyqësorit, për shkak të buxhetit të kufizuar nuk ka burime njerëzore të disponueshme për të realizuar të gjitha objektivat ligjore dhe në këtë kuadër shpeshherë ajo e ka të detyrueshëm të aplikoj skemën e komandimit duke integruar gjyqtar, eksperiencë e të cilëve në fushën e interpretimit të ligjit i mundëson ekspertizë të lartë cilësore.

Për këtë qëllim shprehjen e interesit të znj. {...} për t’u integruar në njësinë ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vlerësuar por nga ana tjetër Këshilli ka në konsideratë edhe ngarkesën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila për shkak të burimeve njerëzore të kufizuara dhe numrit të lartë të gjykimeve është identifikuar si gjykatë në nevojë. Për rrjedhim në vlerësim të mekanizmave që do të mundësojë mos cenimin e interesit më të lartë të gjykatës, moscenimin e numrit të saj të burimeve njerëzore por edhe respektimin e konkurrimit të gjyqtareve nëpërmjet skemës promovuese të lëvizjes paralele, Këshilli në respekt edhe të parimit të proporcionalitetit vlerëson të aplikojë në mënyrë atipike skemën e transferimit me pëlqim në përputhje me nenin 42, 46 të ligjit nr.96/2016. Qëllimi i këtij neni është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm në respektim të funksionit të magjistratit por edhe sipas nevojave të sistemit të drejtësisë. Duke

vendosur disa parime bazë, mbi të cilat kryhet transferimi, ligjvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave respektive. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe parashikueshmëri për magjistratin, i cili mund t'i nënshtrohet lëvizjes në pozicion.

Më konkretisht gjatë vitit 2023 për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Këshilli ka përdorur dy mekanizmat: i) lëvizjen paralele; ii) transferimin e përkohshëm me pëlqim. Përkatësisht me vendimet nr.21-24, datë 18.01.2023 hapi procedurat e lëvizjeve paralele në këtë gjykatë. Procedura është përmbyllur me sukses, vetëm për 1 (një) pozicion (pozicioni nr.21) dhe vijon ende procedura për të tre pozicionet e tjera (22-24), ku kandidatët janë kualifikuar dhe po vijohet me vlerësimin etik dhe profesional të tyre.

Në pozicionin nr. 22 është kandidat e vetme znj. {...}. Për këtë kandidatë është administruar vendimi nr.333, datë 21.06.2023 të Këshillit me anë të të cilit është vendosur “Kualifikimi dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele..”. Për këtë kandidatë është duke vijuar procedura e vlerësimit etik dhe profesional konkretisht në fazën e pritjes të dërgimit nga ILD-ja të rezultateve të verifikimit të 6-ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës. Informacioni i fundit nga ILD-ja është dërguar me shkresën nr. 459/2, datë 23.02.2024.

Në pozicionin nr.23, kandidat i vetëm është z. {...}. Për këtë kandidat Këshilli me vendimin nr. 332, datë 21.06.2023 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Për këtë kandidat është duke vijuar procedura e vlerësimit etik dhe profesional konkretisht në fazën e pritje të dërgimit nga ILD-ja të rezultateve të verifikimit të 1-ankese të paraqitura ndaj gjyqtarit. Informacioni i fundit i marrë është ai i marrë më datë 23.02.2024, ku ankesa vazhdon të jetë në fazën e shqyrtimit fillestar.

Në pozicionin nr. 24 është kandidat e vetme znj. {...}. Për këtë kandidatë Këshilli me vendimin nr.500, datë 28.09.2023 ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele. Për këtë kandidatë është duke vijuar procedura e vlerësimit etik dhe profesional konkretisht në fazën e dërgimit nga ILD-ja të rezultateve të verifikimit të 2-ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës. Informacioni i fundit është ai i datës 23.02.2024. Të dyja ankesat ndodhen në fazë verifikimi.

Gjatë vitit 2024 për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Këshilli ka hapur edhe 5 (pesë) pozicione të lira nëpërmjet lëvizjes paralele, 3(tre) në fushën civile nr. 82-84 dhe 2 (dy) në fushën penale nr. 85-86, datë 20.02.2024.

Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit për këto pozicione, por duke qenë se në të gjithë pozicionet janë kandidatë me 2 (dy) ose 1 (një) vlerësim parashikohet që të zgjasë në kohë procedura e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.

Në bazë të informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ngarkesa e gjykatës rezulton të jetë 5009 çështje në shqyrtim (*lapsus referimi nga z. Toro - 5900*).

Pra në këtë panoramë të paraqitur si më lart, si edhe masave të aplikuara nga Këshilli gjatë vitit 2023 dhe përgjatë vitit 2024, rezulton se mekanizmi i lëvizjes paralele zgjat më tepër në kohë, (për 9 pozicione të shpallura nëpërmjet lëvizjes paralele, vetëm për 1 (një) pozicion ka përfunduar procedura, ndërsa për 8 (tetë) pozicionet e tjera vijon procedura).

Kështu që në këtë kontekst Komisioni vlerëson se procedurat e lëvizjes paralele do të kërkojnë një kohë të caktuar, pasi janë të ndërlidhura dhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që kandidojnë. Me qëllim për të paraprirë procesin e lëvizjes paralele, si edhe për të përmirësuar situatën në këto gjykata, Komisioni ka propozuar që për këtë gjykatë të përdoret procedura e transferimit të përkohshëm e parashikuar nga neni 46 i Ligjit për Statusin, si një nga instrumentet më të shpejtë në kohë, që mund të stabilizojë funksionalitetin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në situatën që ndodhet kjo gjykatë, Komisioni vlerëson se adresimi i nevojave të kësaj gjykate do të realizohet nëpërmjet transferimit të përkohshëm të një gjyqtari me pëlqimin e tij.

Sa i përket hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në rastin konkret, Komisioni vlerëson se ekzistojnë dy kushtet që e lejojnë atë, përcaktuar ato në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016, që rezulton “nuk ka gjyqtarë të disponueshëm në skemën e delegimit; si dhe gjykata është gjykatë në nevojë”. Të dy këto kritere ekzistojnë. Në rastin konkret konstatohet që në skemën e delegimit nuk ka

magjistratë të disponueshëm, pasi 5 gjyqtarët e caktuar tashmë në skemën e delegimit, për shkak të nevojave imediate në pikëpamje të funksionalitetit të Gjykatës Administrative të Apelit janë caktuar për të gjykuar pranë kësaj gjykate. Dihet fakti që kjo gjykatë rezulton të jetë gjykatë të nevojë, kështu që po ashtu edhe skema e parashikuar nga Këshilli nëpërmjet vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, nuk na ndihmon dot, dhe për rrjedhim, për plotësimin e nevojës që paraqet Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Këshilli duhet të orientohet paralelisht edhe në përcaktimet e Rregullores së transferimit të përkohshëm, duke hapur kryesisht procedurën e transferimit të përkohshëm në pozicionin e lirë të përkohshëm pranë kësaj gjykate, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 5, të Rregullores së transferimit të përkohshëm, e cila parashikon: “Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar të disponueshëm, mbi kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin”.

Në këtë kontekst nga ana e Komisionit propozohet hapja e procedurës së transferimit të përkohshëm për nga 1 (një) pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”. Me qëllim dhënien e rezultateve sa më të shpejta, Komisioni propozon që instrumenti i transferimit të përkohshëm me pëlqim të ndërlidhet me mekanizmin e lëvizjes paralele. Për këtë arsye vlerësohet që në këtë procedurë të preferohet kandidati i cili është përfshirë në kandidim për lëvizjen paralele në këtë gjykatë, konkretisht znj. {...}. Siç është përmendur në paragrafin nr.9 të këtij relacion, kjo gjyqtare është kandidate e vetme në pozicionin nr. 24 dhe nga Këshilli janë verifikuar kriteret formale për këtë kandidate sipas vendimit nr. 500, datë 28.09.2023 dhe procedura e lëvizjes paralele do

të finalizohet menjëherë pas përfundimit të vlerësimit etik dhe profesional i saj. Transferimi i saj me pëlqim në këtë pozicion pa administruar shprehje të tjera interesi nga gjyqtarët është në përputhje edhe me parimin e proporcionalitetit. Duke u nisur nga natyra e së drejtave, është e nevojshme që raporti midis tyre të përcaktohet nga instrumente balancimi të cilat të mundësojnë që ky raport midis të drejtave të realizohet përmes një strukture logjike argumentimi pavarësisht sa të ndryshme janë këto të drejta dhe interesa nga njëri-tjetri. Neni 17 i Kushtetutës përcakton detyrimin që kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të jenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar kufizimin. Pra, raporti përpjesëtimor duhet të dëshmojë se në çmasë kjo përballje midis të drejtave mundëson një balancë të drejtë midis të drejtës së kufizuar (mjete) dhe mbrojtjes së një interesi publik ose të të drejtës së të tjerëve (qëllimi). Tradicionalisht ky parim konsiderohet se përbëhet nga 3 elementë. Këshilli duhet të vlerësojë nëse masa e ndërmarrë për të mbrojtur një interes të ligjshëm është: a) e përshtatshme për arritjen e objektivit të kërkuar. b) e domosdoshme, në kuptimin që KLGJ nuk kishte asnjë mundësi tjetër në dispozicion që të jetë më pak kufizuese ndaj pjesëmarrjes së hapur të gjyqtarëve të tjerë dhe të mos shkaktojë cenim të konkurrimit në procedurën e lëvizjes paralele. Kjo do të thotë se masa e ndërmarrë duhet të jetë e nevojshme për të përmbushur një qëllim të caktuar, përmbushjen e detyrimit për finalizimin e procedurës së lëvizjes paralele, dhe se ky i fundit nuk mund të arrihet me anë të masave të tjera të cilat janë të efektshme dhe njëkohësisht më pak të dëmshme për interesat e individëve; c) proporcionale në kuptimin e ngushtë të saj. Në bazë të këtij elementi të tretë, kontrolli është i orientuar drejt peshimit të interesave të përfshira në konflikt. Pra, përparësitë për të cilat ajo është e preferuar mbi masa të tjera, nuk janë në përpjesëtim me dëmin që ato shkaktojnë. Nën këtë optike pavarësisht se skema e transferimit me pëlqim kërkon si fillim kërkesën për shprehje interesi nga shumë gjyqtar të cilat plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në këtë skemë, paraqitja e saj vetëm gjyqtarës e cila nëpërmjet lëvizjes paralele, (skemë kryesore promovuese që parashikon ligji), ka pritshmëri dhe siguri juridike për tu caktuar në atë pozicion por që për shkak të mos përfundimit të vlerësimit etikë profesional e ka të pamundur të caktohet nëpërmjet saj, Këshilli duke çmuar të aplikoje skemën e transferimit të përkohshëm me pëlqim duke ftuar vetëm këtë gjyqtare, harmonizon drejt procesin e kufizimit të konkurrimit të shumë gjyqtarëve në skemën e transferimit në funksion të

respektimit të procedurës së lëvizjes paralele duke ruajtur interesin publik me të drejta të tjera.

Referuar gjykatës në të cilën vjen kjo gjyqtare është paraqitur në mënyrë grafike: struktura organizative e cila është 7, efektivisht janë 4. Ndërkohë që numri i çështjeve për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër rezulton të jetë 1318 duke marrë një ngarkesë mesatare në 200-300 çështje gjyqësore për gjyqtar.

Në transferimin me pëlqim të znj. {...} Këshilli do të marrë në konsideratë edhe vijueshmërinë e përfundimit të çështjeve gjyqësore që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe drafti i vendimit, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtares znj. {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, e cila ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda datës së sotme.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë në rastin eventual të miratimit të këtij projekti nga ana e Këshillit ftoj stafin të marrë pëlqimin e gjyqtares në mënyrë që të mundësojë relativimin e projektvendimit përkatës.

Ndërkohë, në rast të miratimit të këtij projektvendimi, nëse ai kthehet në vendim, ftoj stafin të sjellë pëlqimin nga gjyqtarja dhe njëkohësisht në bazë të informacionit që disponojmë, edhe heqjen dorë nga pozicioni i zëvendëskryetares së kësaj gjykate. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Keni diskutime për sa u parashtrua?

Po zoti Kurushi!

**Klodian Kurushi:** Atëherë vetëm për të shtuar diçka në lidhje me atë çfarë relatoi kolegu. Jemi të informuar nëpërmjet rrugës elektronike nga ish-zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, znj. {...}, që ajo ka hequr dorë nga pozicioni i zëvendëskryetares së gjykatës dhe ajo pjesë e njoftimit besoj se do jetë pjesë edhe e çështjes që lidhet me transferimin e saj përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Faleminderit!

Pra ajo ka hequr dorë si zëvendëskryetare. Aktualisht sot që ne po diskutojmë nuk është më në pozicionin e zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës znj. {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, e cila ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës së sotme.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>5</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Markelian Koça</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>5</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

**9. Emona Muçi** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
6. **Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
7. **Edmond Hoxhaj, Birn.**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Për arsye teknike u shkëput lidhja. Vazhdojmë mbledhjen.

Në vijim të kësaj mbledhjeje, na është përcjellë me postë elektronike materialet për një çështje që ka të bëjë me fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}. Duke vlerësuar nevojën e shqyrtimit sa më shpejt të kësaj çështjeje dhe

shqetësimin që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor për uljen e vakancave në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, propozoj me votimin përkatës përfshirjen e kësaj çështjeje për shqyrtim në këtë mbledhje të ditës së sotme.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord

**Ilir Rusi:** Dakord.

Pjesë e këtij rendi dite bëhet edhe shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”.

**Ilir Rusi:** Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Rusi!

Relacioni i radhës i referohet gjendjes së faktit dhe ligjit të zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kriterëve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatës znj. {...}.

Me disa vendime të datës 20.02.2024, Këshilli ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile (nr. 76) dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale (nr. 81).

Afati i kandidimit ka qenë deri në datën 01.03.2024. Brenda këtij afati kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale kandidoi edhe znj. {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Kandidatja më parë kishte aplikuar në pozicione të ngritjes në detyrë. Në zbatim të pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, ajo ka njoftuar së bashku me këto aplikime se ka hequr dorë nga kandidimet për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, konkretisht për pozicionet nr. 502, datë 21.11.2022 (fusha penale), dhe nr. 247 datë 24.05.2023 (fusha civile). Për këto kërkesa për heqje dorë nga kandidimet, Këshilli është shprehur me vendimet nr.135 dhe nr. 136, datë 13.03.2024.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr. 76/2024 dhe nr. 81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}. Pra zonjës {...} mund t'i bëhen dy vlerësime etike dhe profesionale.

Më datë 13.03.2024, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele edhe për pozicionin nr. 76 dhe nr. 81, dhe relator mbi bazën e shortit të realizuar në Këshill jam caktuar unë për të vijuar më tej procedurat e verifikimit të kriterëve formale ligjore për kandidaten znj. {...}.

Ky vendim iu njoftua znj. {...} dhe ajo nuk pati kontestime në lidhje me përzgjedhjen e relatorit për të filluar procedurën e verifikimit të kriterëve formale ligjore.

Komisioni ka verifikuar tre kriteret e parashikuara në nenin 43 të ligjit “Për statusin”, që janë: “përvoja profesionale minimale specifike”, rastet nëse ajo ka apo jo masë disiplinore në ngarkim për shkak të funksionit të saj si dhe rastet e papajtueshmërisë ambientale.

Për verifikimin e kriterit të “Përvojës profesionale minimale” dhe të “mospasjes masë disiplinore”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, më datë 19.03.2024 përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj.{...}.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit:

Siç thashë, i referohemi nenit 43, pika 6 e tij, ku ndër të tjera parashikohet se magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë.

Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar si për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 76/2024, ashtu edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale shpallur me vendimin nr. 81/2024, çka do të thotë se kandidatja duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

Në lidhje me përvojën e profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016 dhe ka përvojë prej 9 vjet e gjysmë magjistrate në seksionin civil dhe penal.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015. Me dekretin nr. {...}, datë 31.10.2014 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekretin nr. {...}, datë 23.06.2016 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan datë 30.09.2020, renditet e dyta nga kandidaturat për pozicionin Zëvendëskryetare e gjykatës, dhe nga data 09.06.2021 ka ushtruar funksionin e Zv/Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (si pjesë e mbetur nga mandati i Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan). Me vendimin nr. 139, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës

së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”, nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si Zëvendëskryetare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të kësaj gjykate, rizgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale në pesë vitet e fundit, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Elbasanit, rezulton se: “1. Me vendimin nr. 11/18 datë 06.07.2016 të kryetarit të gjykatës z. {...} është caktuar gjyqtarja {...} në seksionin civil. 2. Me vendim e datës 30.12.2020 të Këshillit të Gjykatës është caktuar gjyqtare {...} në seksionin penal (pika 2 dhe 3). 3. Me vendimin nr. prot. {...}, datë 12.05.2021 janë shkrire seksionet dhe gjyqtare {...} ka vijuar gjykimet civile dhe penale. 4. Me vendimin e datës 27.10.2023 të Këshillit të Gjykatës janë ndarë përsëri seksionet ku gjyqtare {...} ka vijuar në seksionin penal. Pra nga llogaritja kohore kjo gjyqtare ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe penale brenda 5 viteve të fundit, më tepër se një vit si në seksionin civil ashtu edhe në seksionin penal në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Pra plotëson kriteret e pozicionit nr. 76 dhe nr. 81 datë 20.02.2024, pasi rezulton të ketë një vit përvojë profesionale specifike minimale si në fushën e së drejtës civile si gjyqtare, ashtu edhe në atë penale gjatë 5 viteve të fundit.

Për zonjën {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore”. Nga verifikimet e bëra nuk ka masa disiplinore.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndodhur në këto kushte ne i propozojmë Këshillit kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 76 dhe për pozicionin në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2021, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>6</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <b>Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| 2. <b>Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| 3. <b>Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| 4. <b>Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| 5. <b>Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| 6. <b>Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| 7. <b>Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| 8. <b>Emona Muçi</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| 9. <b>Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>6</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*Shënim 2:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2021, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2021, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Zoti {...} nuk do marrë pjesë në shqyrtimin e këtij projektvendimi. Për më tej fjalën znj. Rupa.

**Yllka Rupa:** Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendim nr.178, datë 11.05.2022 ka vendosur për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, për shkak të përfundimit të mandatit të z. Medi Bici.

Me vendimin nr.220, datë 20.06.2022, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022 të Këshillit gjyqtarin {...}.

Këshilli gjithashtu ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, përfshirë dhe z. {...}.

Në datën 09.10.2023, Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve me vendimin nr.1 ka zgjedhur z. {...} në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në datën 12.12.2023 z. {...} ka filluar ushtrimin e mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2021 për gjyqtarin nuk kishte përfunduar deri në momentin që ai ka filluar ushtrimin e funksionit si anëtar i Këshillit.

Ndërkohë që procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk ka përfunduar, Këshilli mbështetur në pikën 2, të nenit 64, në pikën 3, të nenit 90 dhe në pikën 1, të nenit 94, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për pozicionin e lirë.

Pas përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kandidatit, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2021

nuk mund të vazhdojë. Kjo procedurë vlerësimi, e filluar në rastin konkret për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë, zhvillohet bazuar në nenin 97, pika 1 të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se:

1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.”

Rezulton se, shkak për të cilin procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar ka filluar nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin kishte filluar.

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr. 263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Në rastin konkret, me deklarimin e përfundimit të procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtarit, shkak për të cilin kishte filluar me prioritet procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar për vitin kalendarik 2021 për gjyqtarin {...}, për shkak të përfundimit të procedurës për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 121, datë 06.03.2024.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës t’i njoftohet gjyqtarit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2021, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2021, për gjyqtarin {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 121 datë 06.03.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Viti kalendarik 2021 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>7</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>7</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

8. *Emona Muçi* (anëtare)  
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*Shënim 2:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 7 të këtij rendi dite.

Zoti Koça nuk do marrë pjesë as në diskutimin, shqyrtimin, votimin e pikës 7 të këtij rendi dite.



Vazhdojmë me pikën 7 që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Rusi!

Me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimi kandidoi edhe znj. {...}.

KLJGJ me vendimin e datës 24.05.2023 vendosi ndër të tjera: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe më tej për Gjykatën Administrative të Apelit. U caktua si relator për kandidaten znj. {...} (unë), pra Klodian Kurushi:

Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Verifikimet: “Përvoja profesionale minimale”. Po i bie në mënyrë më sintetike prezantimin aty ku është më e rëndësishme për t’u evidentuar si fakte.

“Përvoja profesionale minimale” – i referohemi nenit 47, pika 4 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 12.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekretin nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me vendimin nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 10 vite.

Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 246, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë të paktën 5-vjeçare.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Tiranë për kandidaten znj. {...}, rezulton se referuar muaji janar deri në dhjetor 2013, pra për 1 vit, ajo ka gjykuar çështje civile themeli 98 dhe ka përfunduar 68 prej tyre; Urdhra ekzekutimi ka përfunduar 163; Kërkesa civile 19, Kërkesa penale 2; Gjithsej 252 (ku bie në sy që në atë vit ka gjykuar më tepër çështje të natyrës civile).

Për periudhën 05.10.2015 deri më datë 18.07.2016 ka qenë pjesë e dhomës penale; Për periudhën 18.07.2016 - 11.09.2017 ka qenë pjesë e dhomës civile; Për

periudhën 11.09.2017 – 09.05.2018 ka qenë pjesë e seksionit tregtar; Për periudhën 10.01.2019 e vijim shkrihet seksioni tregtar, dhe gjyqtarja bën pjesë në Dhomën Civile; Për periudhën 31.07.2019 – 24.05.2021 ka qenë pjesë e seksionit civil;

Gjyqtarja {...} është përjashtuar nga shorti më datë 24.05.2021 për shkak të lejes së barrë lindjes; me këtë vendim është vendosur gjithashtu edhe bashkimi i seksionit penal me atë civil deri më 16.06.2023.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, rezulton se znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 246, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Ka rezultuar që përtej deklaramentit të saj dhe nga verifikimet nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Njëkohësisht për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, kriter i cili parashikohet në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin. Ajo ka sjellë deklaratën e saj, nga përmbajtja e së cilës rezulton se ajo nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të Ligjit nr. 96/2016.

Nga verifikimi i bërë nga ana jonë nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar prej kandidates.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Këto janë verifikimet e bëra nga Komisioni që lidhen me tre kriteret formale ligjore të kandidimit të saj. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj***: Dakord.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Emona Muçi***: Dakord.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Illir Rusi***: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 246 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 246 datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>8</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>2. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>3. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>4. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Markelian Koça</i></b>  | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>8</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

9. *Emona Muçi* (anëtare)

10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite. Ftoj administratën të njoftojë z. Markelian Koça të jetë pjesë e vijueshmërisë së mbledhjes.

Pika 8 shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të

Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Rusi!

Zoti {...} deri në paraqitjen e këtij relacioni ka qenë kandidat në pozicionin e lirë nr. 500, datë 21.11.2022 të shpallur nga KLGJ si kandidat në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në vijim të verifikimit që ne bëjmë për procedurat e verifikimit të pasurisë dhe të figurës pasi ka kaluar pjesa e verifikimit të kritereve formale, zoti {...} me kërkesën e paraqitur në Këshill datë 01.03.2024, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot, datë 01.03.2024 paraqiti një kërkesë me objekt “Heqje dorë nga ngritja në detyrë” duke shprehur vullnetin se heq dorë nga pozicioni nr. 500/2022 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në rrethanat e mësipërme, ne si Komision, pasi morëm në shqyrtim kërkesën dhe pozicionin për të cilin kandidati ka paraqitur kërkesën për heqje dorë, i propozojmë Këshillit: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Një kopje e arsyetuar e vendimit propozojmë t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Këto propozime ne i mbështesim në nenin 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Faleminderit!



**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Nuk dëgjohet vota.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Për arsye teknike nuk është dëgjuar vullneti i zotit Koça.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Ky vullneti i sapo shprehur nga z. Koça ka të bëjë me vullnetin e shprehur më parë në lidhje me projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9.2 Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>9</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <b><i>Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| 2. <b><i>Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| 3. <b><i>Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| 4. <b><i>Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| 5. <b><i>Gentiana Muçaj</i></b>  | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| 6. <b><i>Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>9</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Emona Muçi* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9.2 Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro): Janë dy projekt-akte: Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Relacioni në fjalë ka lidhje me renditjen e kandidates së vetme për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023. Përbëhet nga relacioni dhe dy projektvendime. Projektvendimi i parë është renditja dhe projektvendimi i dytë është transferimi përfundimtar i zonjës {...} procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Me disa vendime të datës 24.05.2023, konkretisht me vendimin nr. 252, është iniciuar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale. Kandidatët që kanë marrë pjesë në të janë {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Gjatë vijimit të procedurave kandidatja e vetme me 1 (një) vlerësim, znj. {...}, u tërhoq nga kandidimi i saj për këtë pozicion të lirë, dhe Këshillit me vendimin nr. 126, datë 11.03.2024 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.”

Ndërkohë me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të

shpallura me vendimet nr. 248, 250, 251, 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Siç e relatuam edhe më parë për këtë pozicion fillimisht kanë aplikuar gjashtë kandidatë, respektivisht zonja {...} për të cilën nuk filloi procedura e verifikimit për këtë pozicion pasi u transferua nëpërmjet lëvizjes paralele në pozicionin nr. 21/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; znj. {...}, për të cilën nuk filloi procedura e verifikimit për këtë pozicion pasi u transferua nëpërmjet lëvizjes paralele në pozicionin nr. 253/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; znj. {...}, për të cilën nuk filloi procedura e verifikimit për këtë pozicion pasi hoqi dorë nga kandidimi në këtë pozicion, dhe u transferua nëpërmjet lëvizjes paralele në pozicionin nr. 15/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Znj. {...}, për të cilën nuk filloi procedura e verifikimit për këtë pozicion pasi hoqi dorë me kërkesën nr. 1 {...} prot., datë 29.02.2024.

Për kandidaten znj. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 465, datë 25.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253 dhe datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë që me vendimin nr. 144, datë 19.03.2024, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 252 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim, dhe në pikën 2 (dy) të tij u vendos se për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, procedurat e verifikimit do të ishin të vlefshme edhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023.

Pra kandidatja e vetme e kualifikuar për këtë pozicion i përket kategorisë së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional. Hapat dhe kriteret për renditjen e tyre

janë parashikuar në mënyrë të detajuar në seksionin Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020.

Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: “Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”. Për sa më lart, në respektim edhe të përfundimeve të vendimit të Këshillit nr. 346, datë 27.06.2023, këtyre kandidatëve nuk u bëhet asnjë vlerësim nga Këshilli.

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320/2020, nga ana e relatorit janë administruar dokumentacioni përkatës dhe konkretisht certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për këtë kandidat, si edhe listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në qershor 2020.

Konkretisht, nga këto akte rezulton se zonja {...}, kandidatja znj. {...} është diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4067.20 pikësh, nga 4450 të mundshme, me vlerësimin në përqindje prej 91.40%.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një e tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni Ç të vendimit 320/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit DH, Kreu VI, të vendimit 320/2020, relatori përgatiti projektvendimin përkatës i cili është bashkëlidhur këtij relacioni.

Meqenëse kandidatja znj. {...} është e vetme në këtë procedurë të lëvizjes paralele, së bashku me projektvendimin e renditjes është bashkëlidhur edhe projektvendimi për transferimin e znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Nga informacioni i përcjellë nëpërmjet postës elektronike nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, z.{...} ka 93 çështje në total nga të cilat

10 çështje civile/penale të pezulluara, 3 çështje civile në konkluzione përfundimtare dhe 9 çështje penale në diskutim përfundimtar, 19 çështje civile/penale në seancë gjyqësore, 3 çështje penale në fazën e ekzekutimit, 47 çështje penale në fazën e seancës paraprake/ çështje civile në faze përgatitore si dhe 2 urdhër ekzekutimi, për të cilën Komisioni propozon që për çështjet që janë në konkluzionet e përfundimtare dhe ato në seancë gjyqësore, gjyqtarja duhet të përfundojë shqyrtimin e tyre, siç kemi vepruar rëndomë edhe në raste të tjera të ngjashme.

Përfundimisht, siç relatova më parë, bashkëlidhur këtij relacioni ndodhen edhe dy projektvendime, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni, i pari që ka lidhje me renditjen e kandidatës së vetme, ju propozohet:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidate e vetme Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në rastin hipotetik të miratimit të këtij projektvendimi ju propozohet miratimi i draftit të dytë i cili ka të bëjë me transferimin përfundimtar të zonjës {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan si pasojë e përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele. Në dispozitiv ju sugjerohet të miratoni:

1. Transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si dhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.



3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 08.04.2024.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, fillojmë me votimin e projektvendimit të parë që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord me miratimin e renditjes në procedurën e lëvizjes paralele.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 252, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Ka diskutime në lidhje me projektvendimin e dytë?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë vazhdojmë me votimin e projektvendimit “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

2. Gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si dhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 08.04.2024.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.04.2024)

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>10</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Emona Muçi</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>10</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 10 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Më herët nga ana e Këshillit me vendimin nr. 163, datë 03.04.2024 u hap procedura e transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe në dispozitiv të këtij vendimi u la detyrë njëkohësisht edhe relatorit që të kërkojë pëlqimin e zonjës {...}, aktualisht gjyqtare në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër për të dhënë pëlqim për transferim të përkohshëm si kandidatë e vetme në pozicionin nr. 24 të hapur nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Nga ana e stafit u disponua pëlqimi i cili ka ardhur nëpërmjet postës elektronike të datës 03.04.2024 ora 13:24 ku kjo gjyqtare ka shprehur pëlqimin për transferimin.

Në këto kushte mbetet transferimi i gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe për këtë shkak është përgatitur projektvendimi në dispozitivin e të cilit ju sugjeroni të miratoni:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 08.04.2024.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet zv/kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtares {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Gjykatën Durrës, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.  
Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 08.04.2024.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet zv/kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër dhe Gjykatën Durrës, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>11</sup>*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <i>(anëtar)</i>          |
| <b>9. Emona Muçi</b>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <i>(anëtare)</i>         |

<sup>11</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Emona Muçi*).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 11 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatorit *znj. Muçi*

*Emona Muçi:* Faleminderit!

Në datën 28.02.2024, me nr. {...} prot., është regjistruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesa e *znj. {...}*, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për dhënie leje për kualifikim dhe specializim profesional, për periudhën 08.04.2024 deri në 02.05.2024.

Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron se është nominuar nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe nga Zyra e OPDAT pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Tiranë, për pjesëmarrjen në Programin e Lidershit të Vizionit Ndërkombëtar. Gjyqtarja parashtron se ky program paraqet rendësi të veçantë në lidhje me detyrën që ushtron, pasi është i orientuar në marrjen e njohurive në lidhje me standardet dhe parimet për një sistem gjyqësor të pavarur, transparent dhe në respektim të vlerave morale dhe etike, si dhe në theksimin e rolit të gjyqësorit në forcimin e parimeve të shtetit demokratik përmes realizimit të procesit i rregullt ligjor në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, grave si në fushën familjare, civile dhe penale. Pjesëmarrjen në këtë program gjyqtarja e vlerëson së pari si një vlerësim mjaft pozitiv që i është bërë kandidaturës së saj, si dhe së dyti në drejtim të ndikimit në rritjen e saj profesionale, pasi do t'i jap mundësinë që përmes shkëmbimit të eksperiencës të marrë njohuri për sistemin amerikan të drejtësisë për çështje ligjore dhe më pas në vështrim krahasues në punën e saj si gjyqtare të zbatojë praktikatat më të mira në lidhje me to.

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VI, të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” dhe në mbledhjen e datës 27.03.2024 vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

Lidhur me “Lejet e papaguara”, ato janë parashikuar në nenin 24 të ligjit nr.96/2016, gjithashtu Këshilli ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019.

Sa i përket llojit të lejeve, janë tre lloj lejesh:

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore;

Në kërkesën e znj.{...} parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për arsye kualifikimi dhe specializimi profesional në Programin e Lidershit të Vizionit të OPDAT, me kohëzgjatje nga data 08.04.2024 deri në datën 02.05.2024.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Komisionit i ka rezultuar se:

1. Gjyqtari që kërkon lejen duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Këshillit të paktën 30 ditë para fillimit të lejes së kërkuar e cila në rastin konkret është realizuar.

2. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për të cilën kërkohet leja, kohëzgjatjen saj dhe të dhëna për institucionin pranë të cilit do të zhvillohet aktivitetit kualifikues. Në rastin konkret, ky detyrim i gjyqtares është përmbushur.

3. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues si dhe mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionaliteti të gjykatës. Në rastin konkret kërkesa e gjyqtares është shoqëruar me dokumentacion justifikues që konsiston në kualifikimin dhe specializimin profesional në kuadër të Programit të Lidershipit të Vizionit Ndërkombëtar. Gjithashtu është paraqitur mendimi me shkrim i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në të cilin theksohet se: “Pasi u njoha me kërkesën për leje për kualifikim profesional të gjyqtares znj. {...} për pjesëmarrjen në programin e Lidershipit të Vizionit Ndërkombëtar, për periudhën e kërkuar prej saj, dua t’ju shpreh mendimin tim se kërkesa nuk cenon funksionalitetin e gjykatës dhe përmbushjen e detyra të magjstrates, si dhe se e mbështes në këtë kualifikim duke vlerësuar se do të ndikojë dhe do të jetë një vlerë në punën e gjyqtares”.

Lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, veç mendimit të zëvendëskryetarit parashtruar më sipër, është administruar informacion lidhur me ngarkesën aktuale të gjyqtares nga i cila rezulton se ka në shqyrtim 639 çështje.

4. Leja e kërkuar të mos kalojë afatin maksimal prej 2 vjetësh. Në rastin konkret leja e kërkuar është për një periudhë më të shkurtër se dy vjet dhe konkretisht për periudhën 08.04.2024 deri në 02.05.2024 (24 ditë).

5. Kualifikimi profesional të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit ose të mos bjerë ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë. Lidhur me këtë kriter, nga informacioni i përcjellë bashkëlidhur kërkesës rezulton se kualifikimi/specializimi të cilin gjyqtarja do të finalizojë nëpërmjet pjesëmarrjes në programin si më sipër, është në fushën e ligjit dhe për pasojë, nuk rezulton të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit.

Referuar sa më sipër, Komisioni i propozon mbledhjes plenare miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, nga data 08.04.2024 deri në datën 02.05.2024.

Përfundimisht tërësisht nga shorti i gjyqtares {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me kompetencën e mbledhjes plenare në trajtimin e çështjes konkrete, referuar 97, pika 1 shkronja “a” ligjit 115/2016 të ndryshuar dhe vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pika 4 dhe 6, kompetenca për vendimmarrjen mbi kërkesën për leje të papaguar i përket Këshillit.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimit, duke qenë para një akti individual, akti hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit në referim të nenit 98, pika 2 të ligjit nr. 115/2016.

Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100, të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Illir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së znj.{...}, gjyqtare në Gjykatë në Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, nga data 08.04.2024 deri në datën 02.05.2024.

2. Përgjashtimin tërësisht nga shorti i gjyqtares {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>12</sup>*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Emona Muçi</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>12</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Emona Muçi*).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 12 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Muçi*.

*Emona Muçi:* Faleminderit!

Në datën 11.03.2024, me nr. {...} prot., është regjistruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor kërkesa e *znj. {...}*, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për dhënie leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi profesional në



një institucion trajnimi, jashtë programit të trajtimit vazhdues, për periudhën 13.03.2024 deri në 30.09.2024.

Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron se: “Unë, magjistrate {...} ushtroj detyrën si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr.296, datë 30.05.2023 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është miratuar kërkesa për dhënien e lejes së papaguar, leje prindërore për një periudhë 11 muaj, e cila ka filluar më datë 01.06.2023. Duke qenë se leja e dhënë përfundon me datë 12.03.2024, parashtroj para jush këtë kërkesë për dhënie leje të papaguar për arsye studimore. Kërkesa ime për përfitimin e lejes së papaguar në kuptim të akteve ligjore të cituara më sipër, ka si shkak ndjekjen e studimeve për qëllime kualifikimi profesional, e cila është një nga llojet e lejeve të parashikuara në ligj. Konkretisht, në datën 23.06.2022 jam pranuar në Universitetin {...}, {...}, {...} në programin JD (Juris Doctor) për të ndjekur studimet “full time”. Për shkaqe shëndetësore që lidheshin me periudhën e shtatzënisë, si dhe për shkaqe familjare që konsistojnë në nevojën për përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur, nuk munda të ndjek studimet në muajin shtator 2022, sikundër vijon programi, por vijova ndjekjen e tyre në muajin shtator 2023, në sezonin e vjeshtës. Aktualisht më kanë mbetur edhe 21 kredite për të përfunduar programin”.

Gjithashtu gjyqtarja parashtron se: “Studimet nuk bien në kundërshtim me profesionin e gjyqtarit, janë brenda të njëjtës fushë. Nga ana tjetër, edhe arsyeja që parashtroj është nga rastet që ligji parashikon si mundësi për magjistratin për të marrë leje të papaguar. Për këtë qëllim kërkoj që të miratohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor leje e papaguar nga data 13.03.2024 deri në datën 30.09.2024 për të realizuar efektivisht të drejtën për të përfunduar studimet dhe njëkohësisht të kujdesem për vajzën e mitur.

E vetëdijshme për situatën aktuale dhe nevojat e sistemit gjyqësor për magjistratë, kërkoj mirëkuptimin e Këshillit në vlerësimin e kësaj situatë faktike dhe miratimin nga ana juaj të lejes së papaguar për një periudhë afërsisht gjashtëmuajor, me datë fillimi të lejes nga data 13.03.2024 deri në datën 30.09.2024”.

Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VI, të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” dhe në

mbledhjen e datës 27.03.2024 vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim mbledhjes plenare.

Lidhur me “Lejet e papaguara”, në nenin 24 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kritere për dhënien e lejes së papaguar nga Këshilli dhe njëkohësisht parashikohet se: “Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar” (neni 24, pika 6 i ligjit nr. 96/2016). Në bazë të këtij parashikimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72, datë 20.05.2019 “Mbi lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së këtyre lejeve.

Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 i ligjit nr.96/2016 dhe vendimi nr.72, datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4 të tij, parashikojnë tre lloj lejesh të papaguara, konkretisht:

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. Leje për arsye familjare dhe/ose shëndetësore;

Në kërkesën e znj.{...} parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për qëllime kualifikimi në një institucion arsimor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për 21 kredite, me kohëzgjatje nga data 13.03.2024 deri në datën 30.09.2024.

Në lidhje me këtë çështje, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka vlerësuar se bazuar në rrethanat faktike e kuadrin ligjor të sipërcituar:

1. Gjyqtari që kërkon lejen duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Këshillit të paktën 30 ditë para fillimit të lejes së kërkuar. Në rastin konkret gjyqtarja ka paraqitur kërkesën me shkrim në datën 11.03.2024 ndërkohë që leja kërkohet të fillohet në datën 12.03.2024. Pra, kërkesa nuk është paraqitur më shumë se 30 ditë para kohës së fillimit të specializimit për të cilat kërkohet dhënia e lejes, por vetëm 1 ditë përpara saj.

2. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes për të cilën kërkohet leja, kohëzgjatjen saj dhe të dhëna për institucionin pranë të cilit do të zhvillohet aktiviteti kualifikues. Në rastin konkret, në kërkesën e gjyqtarës përcaktohet qartë arsyeja e

kërkimit të lejes që konsiston në ndjekjen e një semestri përmbyllës për studimet pasuniversitare të filluara më parë. Gjithashtu, është përcaktuar qartë kohëzgjatja e lejes nga data 12.03.2024 deri në datë 30.09.2024, si dhe është përcaktuar institucioni arsimor pranë të cilit gjyqtarja do të ndjekë studimet për të cilat kërkohet leja.

3. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin justifikues, si dhe mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionaliteti të gjykatës. Në rastin konkret kërkesa e gjyqtares {...} është shoqëruar me dokumentacion justifikues që konsiston në ndjekjen e studimeve Juris Doctor për avokatinë. Në lidhje mendimin e kryetarit të gjykatës për cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës nuk rezulton që gjyqtarja të ketë paraqitur bashkëlidhur kërkesës mendimin me shkrim të kryetarit të gjykatës, por në lidhje me këtë informacioni Komisioni ju drejtuar zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e cila shkresën nr. {...} prot, datë 18.03.2024, dërguar nëpërmjet postes elektronike, ndër të tjera thekson se: “Duke mbajtur parasysh organikën efektive të gjykatës dhe ngarkesën me punë të gjyqtarëve (referuar të dhënave statistikore të dërguara më herët me e-mail nga kancelarja e gjykatës) duke mbajtur parasysh edhe arsyet specifike familjare dhe profesionale që parashtron znj. {...} në kërkesën e vet, mendoj se miratimi i lejes ë papaguar nga ane Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të gjykatës”.

Lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, veç mendimit të zëvendëskryetares parashtruar më sipër, është administruar informacion lidhur me ngarkesën aktuale të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate, ku ka rezultuar se ngarkesa mesatare aktuale e gjyqtarëve të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier është 193 çështje për gjyqtar.

4. Leja e kërkuar të mos kalojë afatin maksimal prej 2 vjetësh. Në rastin konkret kërkesa që është paraqitur rishtazi nga ana e kësaj gjyqtareje është më e shkurtër se dy vjet dhe konkretisht për periudhën 13.03.2024 deri në 30.09.2024 (6 muaj e 17 ditë).

Në lidhje me këtë pikë po ju vë në vëmendje Këshillit edhe disa kërkesa të tjera të bëra më herët nga ana e kësaj gjyqtareje dhe konkretisht:

Me vendimin nr. 208, datë 20.05.2021 KLGJ ka miratuar kërkesën e znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për leje

të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1 vit, leje e cila fillon nga data 01.06.2021 deri në datën 01.06.2022.

Gjithashtu më pas është paraqitur kërkesë në datën 24.05.2022 po nga ana e gjyqtares për zgjatjen e afatit të lejes së papaguar dhe me vendimin nr. 200, datë 31.05.2022 nga ana e Këshillit është vendosur miratimi i kërkesës së gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për zgjatjen e afatit të lejes për arsye familjare, të dhënë me vendimin e KLGJ-së nr. 208, datë 20.05.2021, për periudhën tjetër 1-vjeçare, deri në datën 01.06.2023.

Më datë 23.05.2023, nga ana e gjyqtares është paraqitur një kërkesë për dhënie të lejes së papaguar, leje prindërore për shkak të lindjes së një fëmije. Theksoj se në kërkesën e saj është parashikuar mundësia që në rast se Këshilli nuk do të pranonte lejen prindërore për shkak të mosplotësimin të njërit prej kushteve, atë të një vit eksperiencë pune, Këshilli të merrte parasysh edhe shkakun tjetër që tashmë kishte filluar studimet pranë këtij Universiteti pranë të cilit bëhet fjalë. Në kohë, Këshilli me vendimmarrjen e tij të datës 10.05.2023, me vendimin 296, ka vendosur miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 01.06.2023 deri në datën 12.03.2024. Në arsyetimin e vendimit kjo leje është quajtur për afat 11-mujor nga lindja e fëmijës.

5. Kualifikimi profesional të mos ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit ose të mos bjerë ndesh me interesat kryesore të funksionit dhe vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë, - rezulton se nga letra e pranimit të Universitetit, ndër të tjera, është theksuar: “...Në këtë klimë, ne jemi të ndjeshëm ndaj vendimeve që po merrni për të ndjekur ëndrrën tuaj për t’u bërë avokat dhe jetën e përditshme siç e njohim tani...” dhe për pasojë, rezulton të ketë mospërputhje me funksionin e gjyqtarit, si dhe bie ndesh me interesat kryesore të funksionit të gjyqtarit.

Për sa më sipër, Komisioni i ka propozuar mbledhjes plenare

Refuzimin e kërkesës së znj.{...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi, për një periudhë 6- mujore, nga data 13 mars 2024 – 30 shtator 2024.

Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me kompetencën e mbledhjes plenare në trajtimin e çështjes konkrete, referuar nenit 97, pika 1 shkronja “a” të ligjit 115/2016 të ndryshuar dhe vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pika 4 dhe 6, kompetenca për vendimmarrjen mbi kërkesën për leje të papaguar i përket Këshillit.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimit, duke qenë se jemi para një akti individual, akti hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit në referim të nenit 98, pika 2 të ligjit nr. 115/2016.

Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100, të ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Muçi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po zonja Luli, fjala për ju.

***Fatmira Luli:*** Unë kam kundërshtim, lidhur me këtë relacion, vetëm me shkakun e refuzimit, të jetë afati i kalimit dyvjeçar të lejes që ka konsumuar, sepse atë e ndalon ligji. Ajo është shkollë ligji, pavarësisht se thuhet që ëndërr ka të bëhet avokate, por është shkollë ligji, e para. E dyta, nuk dëmtohet funksionaliteti nga shkresat që kemi në dosje. Këto dy arsye nuk janë arsye për refuzimin e lejes. Arsyeja për refuzimin është... Ashtu thua në konkluzione. Thua që është shkollë avokatie që vjen në kundërshtim me funksionin. Lëndët që merren dije merren për juriste dhe është shkollë ligji, dhe ajo këtë kërkon. Ky nuk është shkak për ta refuzuar. Shkak, po, është afati. Për këtë shkak jam vetëm lidhur me shkakun e refuzimit të kërkesës, - kam kundërshtim.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë tek votimi i propozimit të zonjës Luli.

**Ilir Rusi:** Po, fjala për znj. Muçi.

**Emona Muçi:** Atëherë, bëj me dije Këshillin që në lidhje me relacionin, në përmbajtje të arsytimit të vendimit do të jetë parashikuar në një pikë të veçantë edhe kohëzgjatja e lejeve të dhëna. Po, propozoj këtë, për të parashikuar në relacion edhe shkakun tjetër në lidhje afatin e lejeve të papaguara sipas propozimit.

**Ilir Rusi:** Për më tej fjala për zotin Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit për dhënien e fjalës.

Për të sqaruar edhe një herë situatën shkurtimisht.

Bie dakord me propozimin që bëri relatorja dhe për propozimin që bëri profesoreshë Fatmira. Të dyja shkaqet në mendimin tim janë shkaqe ligjore të parashikuara në ligjin “Për statusin”, janë përmendur nga të dyja koleget. Kështu që edhe unë dakordësohem si me propozimin e shkakut të parë që është shumë i rëndësishëm që lidhet me tejkalimin e afateve të lejes që ne i kemi dhënë kandidatës, kështu që nuk mund ta kalojmë më tepër se sa afatet që ne i kemi dhënë kandidatës dhe t’i japim sërish leje kur lejet i kemi dhënë në mënyrë të pandërprerë, aktualisht deri në 2 vite e 9 muaj. Nuk mund t’i japim më tepër se kaq. Njëkohësisht bie dakord edhe me propozimin e dytë që gjen pasqyrim në relacion që i referohet edhe natyrës së lejes që kërkon kandidatja, natyrë që lidhet me profilizimin e saj në një shkollë ligji për avokatinë. Të dyja shkaqet për mua kanë rëndësi, kanë vlerë dhe referuar këtyre dy shkaqeve, kërkesa e saj për mendimin tim duhet të refuzohet. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Atëherë, në vijim të diskutimeve të këtij akti, hedhim në votim propozimet e bëra deri më tani nga zonja Luli, por edhe nga relatorja, të cilat u përmendën nga z. Kurushi, në lidhje me përmbajtjen e relacionit që është pjesë e këtij vendimi.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Dakord.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vazhdojmë në hedhjen në votim të projektvendimit përkatës sipas strukturës së paraqitur nga relatorja.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Emona Muçi:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Refuzimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare në Gjykatë në Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi, për një periudhë 6-mujore, 13 mars 2024 – 30 shtator 2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të

Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>13</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Emona Muçi</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)*</b>        |

<sup>13</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 13 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”, për të cilin është përgatitur relacioni nga znj. Plaku. Gjyqtari nuk ka kundërshtime.

*Irena Plaku:* Atëherë, faleminderit!

Po ju parashtoj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2017-2019.

Procedura e vlerësimit ka filluar me Vendimin nr. 371, datë 13.09.2022, të KLGJ-së si relator fillimisht është caktuar z. Ridvan Hado, nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Janë kryer të gjitha procedurat për mbledhjen e të gjitha të dhënave dhe burimet e vlerësimit. Në pjesën e parë është përshkruar e gjithë procedura.

Me vendimin e datës 22.01.2024, është vendosur plotësimi i dokumentacionit.

Nga gjyqtari është depozituar një shkresë shtesë në datën 19.02.2022 (*lapsus viti, 2024*).

Me vendimin nr. 91, datë 20.02.2024 është bërë zëvendësimi i relatorit duke u caktuar unë si relatore për hartimin e projektraportit. Duke qenë se në vendimin e Komisionit ishte vendosur më parë plotësimi i procedurës, kam vijuar direkt me hartimin e projektraportit.

Projektraporti i është njoftuar gjyqtarit i cili nuk ka paraqitur kundërshtime në rrugë elektronike.

Së pari po kaloj tek kriteri i parë 1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave. Duke qenë se jeni njohur me projektraportin, po kaloj vetëm në konkluzionet përkatëse (duke qenë se raporti është shumë i detajuar lidhur me të dhënat që kanë rezultuar nga burimet e vlerësimit).

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar përgjithësisht provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtari ka aftësi shumë të mira edhe në drejtim të identifikimit të normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e tij. Për këtë tregues është vlerësuar se aftësia e gjyqtarit është “Shumë e lartë” për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 25 pikë.

### 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Rezulton se gjyqtari analizon në mënyrë të detajuar si nga ana abstrakte ashtu edhe referuar provave të marra në raport edhe me provat, dispozitave që gjejnë zbatim në lidhje me çështjen konkrete, konkretisht rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdes i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ. Ka rezultuar se gjatë kësaj kohe gjyqtari ka punuar si në seksionin civil ashtu edhe në penale, në periudha të ndryshme, gjithashtu është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për një periudhë të caktuar në Gjykatën e Pukës.

### 1.B Arsyetimi ligjor

#### 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të tij, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

#### 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Rezulton se gjyqtari ka një strukturë të vetën të vendimmarrjes, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimi është ndarë pjesa përshkruese në disa nëntituj, konkretisht rrethanat e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave, procedura, ligjin e zbatueshëm, arsyetimi ligjor apo vlerësimi i gjykatës. Pjesa e dispozitivit është e plotë dhe përmban të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile, 332/ç, 332/dh, etj., të K.Pr.Penale.

Referuar sa më sipër evidentohet se gjyqtari ka aftësi të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, ku gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga

gjkata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat parashtrohen thuajse në të gjitha vendimmarrjet e gjyqtarit, që janë përgjithësisht pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit. Pas analizës së të dhënave vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në tërësi, referuar nga burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me këtë tregues. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, dhe në disa raste për të mbështetur interpretimin e tij ka referuar në qëndrimeve të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara kryesisht për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Atëherë për kriterin e parë, propozimi është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket treguesit 2. Aftësitë organizative të gjyqtarit.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar Raportit Analitik, rezulton se nga 428 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, nga të cilat 102 janë gjykuar jashtë afatit. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim... ka rezultuar me 23,8 %.

Më pas është bërë një analizë tjetër e të dhënave duke zbritur periudhën që gjyqtari ka qenë me lejen e zakonshme, apo me leje të tjera të dhëna nga kryetari i

gjykatës, dhe ka rezultuar se përqindja e çështjeve që gjyqtari ka gjykuar tej afatit ligjor janë 19.8%, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve, rezulton se për periudhën e vlerësimit gjyqtari ka gjykuar 1172 çështje, nga të cilat 428 çështje parashikojnë afati ligjore gjykimi. Pra, 36.5% janë me afat ligjor. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 735 çështje janë me palë kundërshtare.

Ka gjykuar fillimisht në seksionin civil dhe më pas në seksionin penal. Gjithashtu në një periudhë gati njëvjeçare ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë duke vazhduar edhe gjykimet e mbetura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ka rezultuar se gjyqtari e ka tejkualuar në çdo rast standardin minimal të përcaktuar në vendimin e KLGJ-së duke e tejkualuar atë me 90.4 %. Atëherë referuar sa më sipër, duke bërë një analizë të të dhënave, është propozuar pikëzimi i tij me një nivel më të lartë se ai që i përkon të dhënave statistikore duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Në Raportin Analitik, rezulton se nga 744 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 71 prej tyre ose 9.5 % janë gjykuar tej standardit, përqindje e cila sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 5 pikë. Megjithatë edhe në këtë rast janë zbritur edhe çështjet për të cilat është analizë e të dhënave dhe ka rezultuar që përqindja e çështjeve të shqyrtuara tej standardit minimal është 6.3 çështje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 4.

#### 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se në të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.

#### 2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve.

Ka rezultuar se në periudhën trevjeçare është 88.3 %, përqindje e cila pikëzohet me 4 pikë. Duke iu referuar të njëjtës analizë për sa i përket ngarkesës së gjyqtarit, referuar treguesit sasior ku ka rezultuar që gjyqtari e ka tejkualuar me 90.4 %, gjithashtu faktin se ai ka gjykuar në dy gjykata të ndryshme; numrin e çështjeve për të cilën gjyqtari ka rezultuar se ka respektuar në çdo rast standardin minimal kohor sasior, duke qenë çështjet e shqyrtuara tej standardit rreth 6.5 %, është propozuar pikëzimi i tij me 10 pikë për këtë tregues.

#### 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit.

Përgjithësisht koha mesatare e arsyetimit të vendimit për këtë gjyqtar ka rezultuar thuajse në të gjitha çështjet shumë herë më i shkurtër se afatet ligjore të parashikuara si në Kodin e Procedurës Penale ashtu edhe në Kodin e Procedurës Civile, përveç dy kategorive, kërkesave penale të hetimeve paraprake që janë tre prej tyre, është tejkualuar me 0.25 ditë; lejimi i përgjimit që është me 1 ditë që edhe kjo ndikohet për shkak se vendimi jepet i arsyetuar dhe dorëzohet ditën tjetër; Pra po të shikojmë të gjitha afatet e arsyetimit të vendimeve ka rezultuar që janë shumë herë më të shkurtra se ato që ka parashikuar ligji. Megjithatë, duke pasur parasysh që një pjesë, pra tre nga nënkategoritë janë tej afatit, megjithëse janë tej afatit me tejkalime shumë të vogla, sipas metodologjisë së pikëzimit propozohet me 12 pikë. Megjithatë referuar edhe ngarkesës së gjyqtarit, fakti se ai ka tejkualuar gjithmonë standardin minimal mbi 90% është propozuar pikëzimi i tij me 15 pikë. Pavarësisht se tejkalimet ishin të papërfillshme dhe nuk mund të konsiderohen.

#### 2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave ka rezultuar me 3.45 seanca. Gjithashtu ka rezultuar që gjithmonë çështjet janë shtyrë për arsye procedurale, për shkaqe objektive të pavarura nga veprimet e gjyqtarit, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim. Edhe për këtë tregues, pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit, faktin se ka punuar në dy gjykata të ndryshme, faktin se është tejkualuar nga 3 seanca me 0.4 seanca, është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

#### 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale.

Edhe për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka treguar aftësi të larta. Gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Edhe për këtë tregues ka rezultuar se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë, është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), duke u ndarë sipas datave. Bazuar në sa më sipër propozohet pikëzimi me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi maksimal, pasi rezulton që të gjitha aktet në dosje janë të plota. Në dosje rezulton që jo vetëm është njoftuar por është edhe kopja e letrës së të drejtave që i njoftohet të pandehurit, personit nën hetim, bashkëngjitur njoftimit të tyre. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të kriterit është 100 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket 3. Etikës dhe angazhimit të vlerave profesionale, rezulton se gjyqtari ka treguar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion. Ka shmangur shfaqjen e pahijshme, nderin dhe dinjitetin. Nuk përdor gjuhë diskriminuese. Në tërësi nuk rezulton që të ketë një numër, domethënë nuk ka numër të konsiderueshëm të kërkesave për përjashtim (është paraqitur vetëm 1 nga 7 kërkesa). Për sa më sipër është vlerësuar i pakosndierueshëm.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e tretë është 100 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional.

Rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent si në akte ashtu edhe në vendimet e tij.

Respektimi i konfidencialitetit – nuk ka të dhëna që mund të ndikojnë në këtë tregues.



Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët por edhe me administratën rezulton e lartë. Nuk ka tregues që mund të ndikojnë lidhur me këtë tregues.

Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, konkretisht në pjesëmarrjen e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues. Rezulton se ka marrë pjesë në 29 (njëzetënëntë) aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë periudhës së vlerësimit, gjithsej 48 ditë, duke qenë brenda kufijve të përcaktuar në rregullore për këtë arsye është propozuar në rregullore. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 20 pikë.

Konkretisht Gjatë periudhës së vlerësimit, ka marrë pjesë jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës në një trajnim njëjavor në Malin e Zi.

Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë nuk rezulton që gjyqtari të ketë udhëhequr kandidatë apo të jetë angazhuar në cilësinë e lehtësuesit dhe ekspertit pranë Shkollën e Magjistraturës, për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë për këtë tregues.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale ka rezultuar se referuar raportit analitik dhe vetëdeklarimit të gjyqtarit në raportin e vlerësimit, ka deklaruar se ka marrë pjesë në disa aktivitete, konkretisht: “Jam pjesë e anëtarëve të unionit të gjyqtarëve; Kam dhënë kontribut në përgatitjen e kërkesë-padisë, parashtrimeve dhe konkluzioneve. Në vitin 2019 kam zhvilluar disa leksione të hapura në Fakultetin e Drejtësisë; Kam marrë pjesë edhe në takimet e zhvilluara nga Euralius.

Lidhur me këtë tregues në metodologjinë e pikëzimit parashikohet se duhet të jetë kontributi personal i gjyqtarit, angazhimi i gjyqtarit.

Referuar shkresës së datës 19.02.2024, protokolluar në KLGJ, rezulton se, është bashkëngjitur si provë një vërtetim të lëshuar në datën 19.02.2024 lëshuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, ku rezulton se ka dhënë leksione të hapura për temën “Gjykim i shkurtuar” në vitin 2017-2018 dhe në vitin 2021-2022.

Gjithashtu ky gjyqtar ka paraqitur edhe disa vërtetime të lëshuara nga kryetari i gjykatës dhe nga kancelari ku rezulton se janë caktuar disa studentë të Fakultetit të Drejtësisë “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, ku rezulton se tek ky i fundit janë caktuar për të ndjekur praktikën profesionale.

Lidhur me këtë tregues kam vlerësuar se ka të dhëna që mund të ndikojnë në

vlerësimin e gjyqtarit për sa i përket aktivitetit të mësimdhënies në Fakulteti e Drejtësisë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Në lidhje me angazhimin në studentët e drejtësisë, nuk vlerësoj se mund të konsiderohet praktika profesionale si kontribut, si veprimtari ndërinstucionale pasi nuk provohet drejtpërdrejt kontributi i gjyqtarit për këtë tregues. Për sa më sipër e kam pikëzuar me 5 pikë vetëm për sa i përket aktivitetit të mësimdhënies.

Publikimet ligjore – nuk rezulton se gjyqtari të ketë publikime ligjore. Për këtë propozohet 0 pikë.

Niveli i përgjithshëm për këtë kriter është 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për të gjitha kriteret është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarit, 100 pikë.

Aftësia organizative, 100 pikë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave, 100 pikë.

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 93 pikë.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit është 393 pikë.

Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Sot paska qenë dita e teknikës. Kështu që rivazhdojmë. Ishim tek momenti në ka diskutime për këtë relacion.

Nuk ka diskutime, kështu që vazhdojmë me votimin.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Dakord.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Markelian Koça:*** Dakord.

**Emona Muçi:** Dakord. (e ripërsërit)

**Yllka Rupa:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord. (e ripërsërit)

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.04.2024)

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

**Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>14</sup>**

**Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

- |                           |                   |
|---------------------------|-------------------|
| 1. <b>Ilir Rusi</b>       | (zëvendëskryetar) |
| 2. <b>Klodian Kurushi</b> | (anëtar)          |
| 3. <b>Fatmira Luli</b>    | (anëtare)         |
| 4. <b>Irena Plaku</b>     | (anëtare)         |
| 5. <b>Gentiana Muçaj</b>  | (anëtare)         |
| 6. <b>Ridvan Hado</b>     | (anëtar)          |
| 7. <b>Alban Toro</b>      | (anëtar)          |
| 8. <b>Markelian Koça</b>  | (anëtar)          |
| 9. <b>Emona Muçi</b>      | (anëtare)         |
| 10. <b>Yllka Rupa</b>     | (anëtare)*        |

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami**.

<sup>14</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
6. **Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)**
7. **Edmond Hoxhaj, Birn.**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”, i përgatitur nga znj. Irena Plaku.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën 14 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”, për të cilin është përgatitur relacioni nga znj. Plaku. Për më tej fjalën relatores, ndërkohë që gjyqtari ka paraqitur një provë.

**Irena Plaku:** Atëherë, faleminderit!

Po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur raportin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2022. Procedura për vlerësimin e përshpejtuar ka filluar me vendimin nr. 325, datë 14.06.2023 për shkak se gjyqtari ka kandiduar për ngritje në detyrë. Pas kryerjes së veprimeve procedurale për plotësimin e dosjes së vlerësimit me vendimin e datës 07.02.2024 është vendosur plotësimi i dosjes. Është hartuar projektraporti dhe i është njoftuar gjyqtarit. Ky i fundit nuk ka paraqitur kundërshtime por ka paraqitur një provë të re. Prova në fakt ishte paraqitur përpara se t’ia njoftoja unë.

Atëherë, duke qenë se është i njëjti gjyqtar, ka rezultuar se gjyqtari ka aftësi shumë të larta për sa i përket treguesit të parë 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave.

E njëjta aftësi e gjyqtarit rezulton edhe tek interpretimi i ligjit ku rezulton se gjyqtari bën interpretim si abstrakt ashtu edhe në raport me provat. Identifikon si ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu evidentohet kujdes për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese dhe të GJEDNJ-së.

Sa i përket 1.B.a Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë. Përdor të gjitha rregullat e drejtshkrimnit. Janë paragrafët të cilët i japin qartësi vendimit.

Gjithashtu sa i përket 1.B.b Strukturës së qëndrueshme rezulton një aftësi shumë e lartë e gjyqtarit. Vendimet janë të ndara përgjithësisht pjesa përshkruese. Vendimet përmbajnë të gjithë elementet procedural. Gjithashtu pjesa përshkruese është ndarë në disa nënpjesë të organizuar, të cilët janë me tituj që orientojnë më mirë lexuesin. Për sa më sipër është vlerësuar se aftësia e tij për këtë tregues është “shumë e lartë”.

Edhe sa i përket 1.B.c Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik konstatohet se vendimi burim vlerësimi në varësi të kompleksitetit të çështjes në pjesën e tyre analitike përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin duke u ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë, etj.

Referuar sa më sipër propozohet vlerësimi i tij për këtë kriter me 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket aftësisë së gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë (*tek treguesi “Aftësisë organizative të gjyqtarit”*), 2.A.a Respektimi i afateve ligjore. Në bazë të analizës së të dhënave rezulton se përqindja e çështjeve për të cilën nuk është respektuar afati me 26.04%, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 9 pikë. Sipas metodologjisë së pikëzimit është bërë edhe një analizë e të dhënave statistikore në raportin për sa i përket aspektit sasior dhe ka rezultuar që gjatë periudhës 1-vjeçare gjyqtari ka gjykuar 648 çështje nga të cilat 449 çështje janë me palë kundërshtare dhe 199 pa palë kundërshtare, duke e tejkaluar kështu standardin sasior me 3.5 herë apo me 344 % e cila është tej standardit minimal të parashikuar duke qenë se gjyqtari ka gjykuar në

seksionin penal. Referuar sa më sipër, duke qenë se kemi një tejkalim rreth 3.5 herë është propozuar pikëzimi i tij me 15 pikë sa i përket këtij treguesi.

Sa i përket 2.A.b Plotësimi të standardeve minimale, rezulton se numri i çështjeve të cilat janë gjykuar tej standardit minimal ka rezultuar 8.5. është bërë edhe një analizë tjetër e të dhënave statistikore dhe ka rezultuar që përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit është mbi 4.2, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 5 pikë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, ka rezultuar përveç “penale kundravajtje” ka rezultuar më e gjatë, të tjerat me 1.7 ditë. Ky tejkalim i standardit minimal prej 4 muajsh duke tejkaluar vetëm për 1.7 ditë, ndërsa për të tjerat është më e shkurtër se afati, standardi minimal. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve, ka rezultuar 93.2% e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 8 pikë. Pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit ku ka rezultuar se e ka tejkaluar standardin minimal me rreth 3.5 herë apo 359%, gjithashtu ka gjykuar edhe si gjyqtar i deleguar gjatë kësaj periudhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, Lezhë dhe tek GJKKO. Sa më sipër është propozuar pikëzimi i tij me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit, ka rezultuar përgjithësisht më e shkurtër se afati procedural e përcaktuar në ligjin përkatës përveçse kërkesa penale të hetimit paraprak me vetëm 2 prej tyre, caktimi i masës e cila jepet e arsyetuar dhe vlerësim arresti e cila është tejkaluar me 1.5 ditë, tejkalim me 1 dhe 1.5 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 15 pikë, pasur parasysh edhe ngarkesën e madhe që ka përballuar gjyqtari.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave ka rezultuar 2.4 seanca. Ka rezultuar se gjyqtari ka zhvilluar të gjitha procedurat, veprimet për vënien në lëvizje të çështjeve, ka mbikëqyrur siç duhet dërgimin pa vonesë, njoftimin e palëve. Të gjitha seancat janë shtyrë për arsye procedurale. Sa më sipër propozohet pikëzimi i tij me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale. Edhe këtu ka rezultuar se gjyqtari kryen siç duhet veprimet procedurale. Rezulton se ka kryer me efikasitet veprimet procedurale, organizimin dhe zhvillimin e procesit duke respektuar afatet procedurale

dhe zhvillimin e tyre dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjyqimit në kohë. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes. Ka rezultuar se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në këtë tregues, për këtë arsye është propozuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit, edhe për këtë tregues rezulton aftësia e gjyqtarit shumë e lartë duke u pikëzuar me 10 pikë, pasur parasysh se ndër të tjera gjyqtari ka administruar edhe letrën e të drejtave.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të kriterit është 100 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Etika në punë rezulton shumë e lartë. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti, nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë në këtë tregues, edhe për sa i përket "Përdorimit dhe gjuhës diskriminuese".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e tretë është 100 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket aftësisë së komunikimit është i qartë dhe transparent. Për këtë arsye është propozuar 25 pikë.

Respektimi i konfidencialitetit nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë në këtë tregues për këtë arsye është propozuar 15 pikë.

Shkalla e komunikimit si me kolegët por edhe me administratën rezulton shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar në pikët maksimale.

Pjesëmarrja e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, konkretisht pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues, rezulton se ka marrë pjesë në një aktivitet trajnues të zhvilluar gjatë periudhës së vlerësimit gjithsej në 2-3 ditë në cilësinë e pjesëmarrësit. Në cilësinë e lehtësuesit ka marrë pjesë në datë 22-23 qershor duke dhënë edhe temën përkatëse. Rezulton se ka kryer 6 ditë trajnimi për afatin 1-vjeçar, pra është brenda afatit të përcaktuar në rregullore. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe trajnimit të gjyqtarëve dhe rezultoi siç e thamë më sipër që gjyqtari ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit në programin e formimit vazhdues të Shkollës së



Magjistraturës. Duke qenë se ka të dhëna propozohet pikëzimi i tij duke shtuar 2 pikë, 5 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Edhe për këtë tregues gjyqtari në raportin analitik (domethënë në vetëvlerësimin e tij) ka paraqitur disa të dhëna, konkretisht siç ishte Unioni i Gjyqtarëve, në fakt janë të njëjta siç i relatova tek raporti i mëparshëm; ka zhvilluar disa leksione të hapura; Në këtë kohë nga ana ime nuk i është dhënë pikë gjyqtarit pasi kam vlerësuar se provat nuk ishin në formën e duhur.

Pas njoftimit të projektraportit, ose ditë më para, janë paraqitur të njëjtat të dhëna burimore, të njëjtat vërtetime që në fakt u mbajt parasysh edhe tek vlerësimi i parë. Janë dërguar të gjitha të dhënat në një datë dhe rezulton se gjyqtari është angazhuar në universitet me leksione të hapura.

Unë në fakt e kam propozuar me 3 pikë në atë moment, por ka sjellë provat më mbrapa.

Ndërsa për sa i përket publikimeve ligjore, nuk rezulton gjatë kësaj periudhe të vlerësimit.

Sa më sipër, propozimi për nivelin e vlerësimit ka qenë 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", për kriterin e katërt.

Propozimi për çdo kriter vlerësimi është:

Aftësia profesionale e gjyqtarit, 100 pikë.

Aftësia organizative, 100 pikë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave, 100 pikë.

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 93 pikë.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit është 393 pikë.

Siç e theksova gjyqtari ka paraqitur një vërtetim i cili ju është njoftuar edhe juve, ku rezulton që ka marrë pjesë në leksione të hapura pranë Fakultetit të Drejtësisë të Durrësit.

Për sa më sipër referuar edhe raportit të vlerësimit të mëparshëm do propozoja për këtë tregues rritjen me 2 pikë niveli. *(Pra shkon në 5 pikë Pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me median dhe publikun të gjykatave.)*

**Ilir Rusi:** Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit, duke përhithur edhe propozimin e bërë nga vetë relatorja për të ngritur 2 pikë tek rubrika *Pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me median dhe publikun të gjykatave*, nga 3 në 5 pikë.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Atëherë, tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” vlerësimi nga 93 pikë shkon në 95 pikë dhe në total vlerësimi i këtij magjistrati është 395 pikë.

Kalojmë tani në votimin në tërësi të këtij projekt-akti, duke marrë në konsideratë edhe miratimin propozimit të bërë nga relatorja.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 15 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 18.01.2024, 24.01.2024 dhe 31.01.2024.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>15</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Markelian Koça** (anëtar)
- 9. Emona Muçi** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)\*

<sup>15</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

15. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 18.01.2024, 24.01.2024 dhe 31.01.2024.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 15 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” të datave: 18.01.2024, 24.01.2024 dhe 31.01.2024.

Keni ndonjë diskutim mbi përmbajtjen e tyre?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin.

*Irena Plaku:* Pro.

*Gentiana Muçaj:* Dakord.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 18.01.2024, 24.01.2024 dhe 31.01.2024.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 15 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.04.2024)

**Pika 16 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>16</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Markelian Koça*** (anëtar)
8. ***Emona Muçi*** (anëtare)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)\*

<sup>16</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

*Shënim 2:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja *znj. Irena Plaku*, e cila do të jetë prezent në çështjet vijuese nëpërmjet platformës ‘online’.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 16 të kësaj mbledhjeje “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga KZHK. Akti relatohet nga z. Markelian Koça, duke qenë se z Kurushi ka relatuar disa nga aktet që u trajtuan në mbledhjen e sotme.

Merr fjalën zoti Koça për të parashtruar shkurtimisht relacionin përkatës.



Deri më datë 02.04.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave në tabelën referuar në relacion.

Nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk mund të plotësohen përmes skemës së delegimit sipas nenit 45 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së KLGJ-së “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, për shkak se në këtë skemë, nuk ka gjyqtarë që plotësojnë kushtet shtesë të sigurisë, siç kërkohet nga shkronja “b”, pika 4, e nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk mund të plotësohen as përmes transferimit të përkohshëm, me ose pa pëlqim, sipas nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së KLGJ-së “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, për shkak se një gjë e tillë ndalohet nga ligji. Konkretisht, në pikën 8, të nenit 42, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Një gjyqtar nuk lejohet të transferohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar”.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit lidhur me sa më lart janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 3(tre).

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër, gjithashtu edhe gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë në GJKKKO: Z{...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}.

Bashkëlidhur relacionit është edhe lista me gjyqtarët që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e shortit si dhe e atyre që kanë pengesë.

Lidhur me sa u parashtrua z. Kurushi parashtron se nga një verifikim i fundit është edhe një gjyqtare e cili nuk duhet të përfshihet në short, znj. {...}, për shkak se ajo është propozuar dhe është shortuar nga KLGJ-ja në procese të ngjashme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe kompleksiteti i çështjeve ka bërë që ajo të jetë shumë herë e pranishme në këtë gjykatë. Kështu që për shkak të ngarkesës, propozohet nga z. Kurushi që edhe gjyqtarja {...} të përjashtohet nga procedura e shortit.

*Lidhur me sa më sipër, votohet dhe pranohet propozimi i z. Kurushi (znj. Plaku është larguar nga mbledhja për t'u futur online nëpërmjet platformës në pikat vijuese të rendit të ditës.)*

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë më kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik duke u bërë përditësimet sipas propozimit të z. Kurushi.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 67, datë 21 mars 2024, gjyqtarët e përzgjedhur janë Artan Çupi (relator) dhe Sokol Shehu dhe Taulant Banushi në cilësinë e anëtarëve të trupit gjykues.

\* \* \*

(Pika 16 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.04.2024)

**Pika 17 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtim i projektvendimit "Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë", i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>17</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)\*
- 5. Gentiana Muçaj** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Markelian Koça** (anëtar)
- 9. Emona Muçi** (anëtare)
- 10. Yllka Rupa** (anëtare)\*

<sup>17</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

17. Shqyrtim i projektvendimit "Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë", i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

*Ilir Rusi:* Përshëndetje!

Vajti pak kohë e gjatë shkëputjeje, por ishte një pushim i domosdoshëm për të qenë sa më efektiv në vijim të kësaj mbledhjeje, për të cilën kemi edhe tre pika të tjera në rendin e ditës.

Vazhdojmë me pikën 17 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë",

për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni përkatës. Për më tej po relatohet nga ana ime Ilir Rusi.

Për ndihmës kanë aplikuar 142 kandidatë. Në zbatim të kompetencave dhe detyrave që kemi ne si komision që bën verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të tyre sipas përcaktimeve ligjore, rezultoi që për 23 ndihmës, në verifikimet paraprake u konstatua mungesë dokumentacioni, për të cilat u komunikua nëpërmjet postës elektronike. Nga ana e 21 kandidatëve u plotësua dokumentacioni, ndërsa nga 2 kandidatë nuk u plotësua dokumentacioni.

Në vijim të procesit, duke marrë për bazë vlerësimin, llojin e arsimimit “Master”, vitet e punës me kohë të plotë në përfundim të studimeve të plota universitare të paktën 3 vjet, mesatare mbi 7 dhe plotësimin e dokumentacioneve të tjera sipas kriterëve të përcaktuara, nga ana e Komisionit u bënë gjetjet dhe konstatimet përkatëse: Për 140 kandidatë Komisioni ka vendosur paraprakisht kualifikimin e tyre për shkak se plotësojnë këto kriterë formale ligjore.

Për 11 kandidatë ka vendosur skualifikimin për shkak të kriterit të mesatares që është nën minimumin e përcaktuar; për shkak të mungesës së përvojës si jurist; për shkak të mungesës së përvojës në raport me vitet e punës nën 3 vjet; në lidhje me mosplotësimin e dokumentacionit; pasjen e masave disiplinore apo mospasjen e llojit arsimimit të duhur.

Ndërsa për 1 kandidate Komisioni vendosi për ta relatuar për diskutim (për shkak edhe të diskutimeve që ka pasur) në këtë mbledhje plenare.

Në lidhje me kandidatët që nuk plotësojnë kriteret:

{...} që ka një mesatare 6.17; {...} mesatare 6.93; {...}, nuk ka përvojën si jurist; {...}, nuk ka përvojë pune si jurist; {...}, ka një përvojë pune më pak se 3 vjet; {...} më pak se 3 vjet; {...}, më pak se 3 vjet; {...}, më pak se 3 vjet; {...}, mungon dokumentacioni përkatës (pavarësisht kërkimeve tona, nuk u plotësua); {...} rezulton që një masë disiplinore “Largim nga puna” sepse nga librezat e punës rezulton “Larguar me masë disiplinore”; {...} nuk ka arsimimin e duhur. Ka një “Master profesional” dhe nuk ka “Master shkencor”.

Ajo çfarë del për diskutim në mbledhje plenare ishte rasti që evidentova, që ishin diskutime dhe qëndrime të ndryshme, rasti është për {...} që rezulton që ajo është e

punësuar pranë institucionit përkatës por ndaj saj është marrë një masë disiplinore dhe në vijim e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë; është marrë vendimi nga Gjykata e Shkallës së Parë, sepse ka bërë kërkesë edhe për sigurimin e padisë dhe sipas vendimit përkatës për sigurimin e kërkesë padisë, prezumohet kjo ekzistenca e masës disiplinore deri në përfundimin e çështjes gjyqësore me vendim të formës së prerë.

Çështja tjetër që është për diskutim është që pavarësisht një vendimi gjyqësor të tillë për sigurimin e kërkesë padisë, rezulton në ekzistencën e saj si e punësuar që të ketë masë disiplinore? Dhe masa disiplinore shtrihet në dy koncepte: së pari, në kohë vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas rastit; dhe në ekzistencën përkatëse në lidhje me marrëdhëniet që krijon me të tretët kandidati në këtë rast, nëse perceptohet që ka masë disiplinore apo jo në momentin kur kemi një vendim për masë siguri kërkesë padie, se në eventualitet, ajo që e përcakton nëse ekziston apo nuk ekziston, apo është e drejtë apo nuk është e drejtë kjo masë disiplinore, është vendimi i formës së prerë. Kjo çështje shtrohet për diskutim dhe komisioni e ka paraqitur në dy momente, sipas vendimit përkatës.

Gjithashtu, sipas dokumentacionit, rezulton që kjo kandidate, kandidon edhe për magistratë, por në këto momente jemi duke vlerësuar kandidimin e saj si ndihmëse ligjore, dhe jemi për të diskutuar nëse ka një masë disiplinore në fuqi apo jo, sepse në kritere thuhet që të mos ketë masë disiplinore “largim” ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Nuk e di nëse keni diskutime për sa u parashtrua?

**Klodian Kurushi:** Atëherë, shkurtimisht, për këtë kandidate për të cilën po diskutojmë dhe e bëjmë pjesë të diskutimit nëpërmjet asaj çfarë tha Zëvendëskryetari, mendoj që kjo kandidate nuk duhet të kualifikohet në këtë rast. Pasi në vlerësimin tim unë konstatoj që ajo ka një masë disiplinore në fuqi, e cila nuk është ndryshuar/nuk është hequr me një vendim të formës së prerë nga gjykata. Jemi në dijeni vetëm të faktit që ajo e ka ankimuar këtë masë disiplinore në gjykatë, por procesi nuk ka përfunduar me një vendim të formës së prerë dhe përfundimtar nga gjykata.

Ndodhur në këto kushte, masa disiplinore është në fuqi dhe referuar ligjit “Për statusin”, kandidati ka pengesë ligjore për të kandiduar qoftë në profilin gjyqtar, qoftë në profilin ndihmës, nëse ai ka një masë disiplinore në fuqi, siç është rasti i kësaj kandidateje. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera?

*(Nuk ka diskutime.)*

Atëherë, hedhim në votim propozimin e sapo bërë në lidhje me skualifikimin e zonjës {...} për shkak të ekzistencës së një mase disiplinore në fuqi.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Atëherë, sipas votimit të bërë në lidhje me propozimin përkatës, rezulton që listës së të skualifikuarve i shtohet edhe kandidatja {...}.

Tashmë projekt-akti do të ketë në vijim të lidhur dy lista, një listë me të kualifikuarit e cila është me numrin rendor 1 dhe përfundon me numër 140, dhe një listë me të skualifikuarit, me numër rendor 1 dhe përfundon me numër rendor 12.

Përgjatë relatimit të tij, relatova edhe emrat e atyre të cilët janë skualifikuar.

Atëherë, nëse nuk keni diskutime të tjera, po hedhim në votim në tërësi aktin, duke marrë në konsideratë listën emërore të të kualifikuarve nga numri 1 deri në 140 dhe listën emërore të të skualifikuarve nga numri 1 deri në 12.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.



*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Illir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të miratojë listën emërore të kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024 – 2025, për Ndhmës Ligjorë, sipas Lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 17 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.04.2024)

**Pika 18 e rendit të ditës me objekt:** Projektvendim "Për miratimin e komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025", i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

**Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>18</sup>**

**Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.**

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Irena Plaku** (anëtare)\*
5. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Markelian Koça** (anëtar)
9. **Emona Muçi** (anëtare)
10. **Yllka Rupa** (anëtare)\*

<sup>18</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
6. *Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

18. Projektvendim "Për miratimin e komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025", i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm.

*Ilir Rusi:* Në vijim të kësaj mbledhjeje të gjatë, po vazhdoj me pikën 18 që ka të bëjë me projektvendim "Për miratimin e komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni përkatës dhe do të raportohet nga ana ime.

Aktet ju janë përcjellë. Ka rezultuar që: 482 (katërqind e tetëdhjetë e dy) kanë qenë kandidatë që plotësonin dokumentacionin sipas dokumenteve të ardhura nga Shkolla

e Magjistraturës; 393 (treqind e nëntëdhjetë e tre) prej tyre ka mbajtur qëndrim Shkolla për t'i kualifikuar; 89 (tetëdhjetë e nëntë) prej tyre për t'i skualifikuar.

Komisioni edhe me qëndrimet e mbajtura në vitet e mëparshme edhe sipas kriterëve formale të përcaktuara, ka bërë gjetjet e veta të cilat i ka përmbledhur në rubrikat përkatëse.

Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se përmbushin kriteret ligjore:

a) Kandidat të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës, për të cilin sugjerohet rishikimi për shkak të mesatares së përgjithshme e cila rezulton nën 8.

1) Për kandidatin {...}, sipas përllogaritjes së mesatares nga Komisioni përkatës i Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton që mesatarja e tij të jetë 7.88.

2) Për kandidaten {...}, sipas përllogaritjes të bëra nga Komisioni rezultoi që mesatarja të jetë 7.75 dhe jo mbi 8 sipas Shkollës së Magjistraturës.

Kategoria tjetër b) Kandidatë të kualifikuar nga Shkolla e Magjistraturës për të cilin sugjerohet rishikimi i përvojës profesionale.

Për aplikantin {...} rezultohet që të rishikohet qëndrimi i Shkollës së Magjistraturës pasi rezulton që vitet e punës janë 2 vite, 10 muaj e 28 ditë.

Për kandidaten {...} (*citohet gabimisht {...} mbiemri*) të rishikohet qëndrimi i Shkollës së Magjistraturës në lidhje me vitet e përvojës profesionale, pasi sipas përllogaritjeve nga Komisioni i ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton që të ketë 2 vite, 6 muaj, 18 ditë.

Për kandidaten {...} Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti qëndrimin e vet në momentin kur diskutoi në lidhje me kandidimin e saj për ndihmëse ligjore dhe vijimin apo jo më tej të këtij kandidimi. Rezultoi që {...} të skualifikohet për shkak të ekzistencës së masës disiplinore në fuqi. Të njëjtin qëndrim mban edhe për kandidimin e saj si magjistrate.

Në lidhje me {...}, Shkolla e Magjistraturës ka mbajtur qëndrim për skualifikimin, por për shkak se kishte një lidhje ndërmjet ekzistencës së masës disiplinore, qëndrimi është i drejtë i mbajtur nga Shkolla e Magjistraturës.

Në lidhje me aplikantët {...}, mesatarja rezulton 8; {...}, rezulton 8; {...}, rezulton 8; {...}, rezulton 8; {...}, rezulton 8.

Lidhur me seksionin “Komente dhe sugjerime për aplikantët që janë vlerësuar paraprakisht se nuk përmbushin kriteret ligjore”.

a) Gjetje mbi kandidatët që janë skualifikuar, të cilat nuk e ndryshojnë statusin e tyre si të skualifikuar:

Për kandidatin {...} janë bërë dy gjetje nga Shkolla e Magjistraturës, një për mesataren që është nën 8 dhe për vitet e punës. Nga përlllogaritja rezulton që mesatarja e tij të jetë mbi 8 (konkretisht jo 7.91 por 8.44).

Në lidhje me kandidaten {...} , sipas gjetjes së Shkollës rezulton që mesatarja të jetë 8.13 dhe vite pune 1 vit e 7 muaj. Rezulton që vite pune është po kaq, por mesatarja të jetë 7.98, pra nën 8.

Në lidhje me {...} rezulton që vitet e punës 3 vite, 5 muaj e 14 ditë.

Për sa i përket kandidates {...}, rezulton edhe në listën e të kualifikuarve dhe në listën e të skualifikuarve, por për shkak të qëndrimit që ka mbajtur Shkolla e Magjistraturës për ata kandidatë të cilët janë ndihmës ligjorë dhe kanë bërë një aktmarrëveshje me Shkollën e Magjistraturës, ka mbajtur qëndrimin për t’u skualifikuar. Kështu që duhet të bëhet rregullimi që kjo kandidate duhet të rezultojë tek lista e të skualifikuarve.

b) Gjetje mbi kandidatët e skualifikuar, të cilët e ndryshojnë statusin e tyre si të skualifikuar:

Është kandidatja {...} e cila sipas Shkollës është në kategorinë e të skualifikuarve. Duke vlerësuar dokumentet, librezën e punës, ka një shënim “largim nga detyra” por largim nga detyra në vetveten e saj nuk është se përbën një masë disiplinore dhe nuk ka një shënim “larguar nga detyra me masë disiplinore”, aq më tepër rezulton që tek i njëjti institucion që ka këtë shënimin “largim nga detyra”, 7 ditë më vonë është ripunësuar përsëri. Ndodhur në këto rrethana i sugjerojmë Shkollës së Magjistraturës të kërkoj informacion në institucionin në të cilin rezulton të jetë ky shënim “largim nga detyra”, për të verifikuar nëse shënimi “largim nga detyra” është si rrjedhojë e një mase disiplinore apo jo, ose për shkak të përfundimit të marrëdhënieve, pra shkaqet për çfarë është përfunduar marrëdhënia. Pra i kërkojmë Shkollës të rishikojë qëndrimin por duke bërë edhe një kërkim dhe duke disponuar për të marrë informacion nga institucioni në të

cilën është e përcaktuar në librezë si institucion përkatës duke marrë argumentin e faktit që edhe 7 ditë më vonë është ripunësuar përsëri tek i njëjti institucion.

Ndërsa në lidhje me kandidatin {...} është vlerësuar në tërësi formimi i tij arsimor, që është jurist. Punët e tij të bëra sipas referimeve përkatëse dhe vërtetimeve përkatëse. Rezulton që një “Letër Rekomandimi” është “Doganier”, në vërtetimin përkatës lëshuar nga institucioni është “Përgjegjës turni” i një sektori. Nga vlerësimi i gjithë kandidatëve rezultoi që ka edhe kandidatë të tjerë që punojnë tek i njëjti sektor dhe Shkolla ka mbajtur qëndrim duke i kualifikuar ata. Kështu që në këto rrethana i sugjeroj Shkollës për të rivlerësuar edhe një herë qëndrimin që ka për këtë kandidat në lidhje me skualifikimin e tij nga ana e Shkollës, pra që të rishikojë qëndrimin e vet duke vlerësuar kualifikimin e tij.

Kjo ishte një përmbledhje sintetike e këtij materiali, sepse ato u janë vënë në dijeni dhe nëse keni diskutime, vazhdojmë më tej.

Keni diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Nuk dëgjohej vota.

*(Zonja Muçi si një nga anëtarët e Komisionit që ka përgatitur materialin nënkupton që është dakord.)*

**Klodian Kurushi:** Dakord me propozimin e plotë dhe shterues të Zëvendëskryetarit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për miratimin e komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit

paraparak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraparak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 18 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 03.04.2024)*

**Pika 19 shtesë<sup>19</sup> e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>20</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 17:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online\*:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)*</b>        |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>  | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Markelian Koça</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Emona Muçi</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>19</sup> Shih procesverbalin e pikës 5.

<sup>20</sup> Znj. Llagami drejton vetëm pikën e parë të mbledhjes. Më tej mbledhja drejtohet nga z. Rusi.



*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe në vijimin e mbledhjes Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 6. Arben Lila, ekspert i projektit EU4Justice (prezent në një pjesë të mbledhjes.)*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

19 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën e fundit të kësaj mbledhjeje e cila u shtua po përgjatë kësaj mbledhjeje, rezulton që është pika 19 dhe është pika e fundit, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me relatore znj. Muçi.

***Emona Muçi: Përshëndetje përsëri!***

Paraprakisht edhe unë desha të falënderoj kryetarin në lidhje me materialin voluminoz (znj, Muçi i referohet dy çështjeve 17 dhe 18 të rendit të ditës.)

Atëherë, në lidhje me miratimin e projektvendimit "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”.

Pas mbarimit të afatit të aplikimit për pozicionet e lira me vendimet nr.239, 240, 242, 243, 244 dhe 247, datë 24.05.2023të shpallura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është zhvilluar procedura e verifikimit për plotësimin e kushteve nga kandidatët aplikues.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes së pozicioneve të lira për ngritje në detyrë parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional.

Rezulton se për të dy kandidatet, gjyqtaret {...} dhe {...}, është vijuar procedura e verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira dhe për këtë arsye nga ana e Komisionit duke mbajtur në vëmendje edhe bazuar në skemën e vlerësimit të gjyqtarëve por edhe në programin e vlerësimeve të miratuara, duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatët e verifikuar, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit për periudhën e vlerësimit për vitin e fundit kalendarik, atë për vitin 2022.

Këshilli me vendime të ndryshme ka vlerësuar plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit:

(i) Me vendimin nr.108, datë 06.03.2024 për gjyqtaren znj. {...};

(ii) Me vendimin nr.110, datë 06.03.2024 për gjyqtaren znj. {...}.

Për gjyqtaret {...} dhe {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, përkatësisht me vendimet nr. 81, datë 16.02.2023 dhe nr. 725, datë 07.12.2023 ka vendosur fillimin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe këto procedura janë ende në proces. Për këto gjyqtarë,

gradimi përbën vlerësimin e parë për efekt të renditjes së kandidatëve në pozicion. Ndërsa vlerësimi i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar i vitit të fundit kalendarik, duke llogaritur vitin e aplikimit 2023.

Për sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar, (viti 2022) për 2 nga gjyqtarët që kanë plotësuar tre kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 1 janar 2022-31 dhjetor 2022 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, mbi bazën e rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe atij nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2022, për gjyqtarët znj.{...} dhe znj.{...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilën prej gjyqtarëve, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12, pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019.

Lidhur me procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar për të cilën duhet të fillojë procedura e vlerësimit, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e Komisionit, znj.Emona Muçi, znj.Irena Plaku dhe znj.Yllka Rupa. Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës që do të angazhohen në vlerësimin etik dhe profesional sipas këtyre projektvendimeve, propozohet të përfshihen në short nëpunësit znj.Erlanda Agaj dhe znj.Merita Karaj, me një ngarkesë pune të barabartë, me nga 1 vlerësim secila.

Lidhur me rregullat e realizimit të shortit, në një enë do të vendosen 2 shirita letre me emrin e secilit gjyqtarë për të cilin do të fillojë procedura e vlerësimit, në një enë

tjetër 3 shirita letre me emrat për secilin anëtar të Komisionit dhe në një ene tjetër, do të vendosen 2 shirita letre me emrin e nëpunëses. Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen fillimisht të emrit të gjyqtarit dhe më pas të vlerësuesve.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Muçi.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Atëherë ftoj administratën të hedhë shortin sipas mekanizmit përkatës.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e dy kandidatëve: znj. {...} dhe znj. {...}.

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi, znj. Yllka Rupa, znj. Irena Plaku.

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Erlanda Agaj, znj. Merita Karaj.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i parë i kandidates, znj. {...}. Për zonjën {...} përzgjidhet relatore znj. Emona Muçi dhe nëpunës përgjegjës znj. Merita Karaj.

Përzgjidhet emri i dytë i kandidates, znj. {...}. Për zonjën {...} përzgjidhet relatore znj. Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit!

Ka diskutime mbi mënyrën e hedhjes së shortit?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit të përditësuar sipas të dhënave të rezultuara nga shorti i sapo hedhur.

*Irena Plaku*: Pro.

*Gentiana Muçaj*: Dakord.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Markelian Koça*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Emona Muçi*: Dakord.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Ilir Rusi*: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022 për gjyqtaret {...} dhe {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtaret znj.{...} dhe znj.{...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtaren znj.{...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

Për gjyqtaren {...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Merita Karaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike, dhe duke ju falenderuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

\* \* \*

(Pika 19 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

141

---

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 03.04.2024 (Pika 19 shtesë)***